Strategjia ka një mekanizëm të qartë të përcaktuar për koordinimin, monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë dhe PLV-ve, duke u shtrirë në nivelin qendror dhe lokal. Siç paraqitet në skemën më poshtë, ZKQM ngarkohet si Sekretariat përgjegjës për koordinimin, monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë. Konkretisht, ZKQM është e mandatuar me zhvillimin e roleve dhe përgjegjësi, dhe koordinimin e aktiviteteve të mekanizmave përgjegjës për zbatimin e Strategjisë. Përveç Sekretariatit, mekanizmat për zbatimin e kësaj Strategjie dhe Planin e saj të Veprimit, në nivelin qendror përfshijnë gjithashtu Pikat e Kontaktit nga Ministrinë përkatëse (arsimi, punësimi dhe mirëqenia sociale, shëndetësia dhe banimi); ndërsa, në nivelin lokal, Strategjia mandaton krijimin e Komiteteve Komunale të Veprimit (KKV).

Në përgjithësi, ZKQM ka rolin kryesor në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të Strategjisë. Si pjesë e mandatit të saj, ZKQM ka zhvilluar Kushtet e Referencës për Pikat e Kontaktit dhe KKV, i cili u ka komunikuar Kushtet e Referencës Kryetarëve të sapo zgjedhur përmes Ministrisë së Administrimit të Qeverisjes Lokale (MAPL) në Tetor, 2017. Kjo e fundit, MAPL lëshoi një letër zyrtare në janar të vitit 2018, drejtuar kryetarëve të komunave të Kosovës, duke u kërkuar atyre që të krijojnë KKV-të, të mandatuara nga Strategjia si një strukturë mbështetëse për monitorimin dhe koordinimin e Strategjisë në nivelin lokal. KKV-të duhet të themelohen në të gjitha komunat që kanë PLV në Kosovë dhe ato duhet të përbëhen nga 11 anëtarë (7 anëtarë nga autoritetet dhe 4 anëtarë nga shoqëria civile që merren me komunitetin rom). Për të ndihmuar më tej zbatimin e Strategjisë, PLV-të janë duke u zhvilluar nga komunat për të promovuar përfshirjen e komunitetit rom në nivelin lokal në komunat përkatëse.




Figura 1: Mekanizmat funksional në nivelin lokal dhe qendror për zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë

2.3.3 Planifikimi buxhetor në nivelin lokal për përfshirjen e romëve

Gjithmonë, të gjitha komunat partnere kanë tre burime kryesore buxhetore për zbatimin e PLV-ve përkatëse, gjegjësisht, buxhetin komunal, donatorët dhe institucionet qendrore. Megjithëse një pikë e veçantë, por që vlen të theksohet, niveli qendror nuk ka një linjë buxheti për të zbatuar aktivitete që vijnë nga Strategjia dhe deri më tani nuk ka pasur ndonjë ndarje të fondeve për zbatimin e Strategjisë.

Siç shihet nga tabela më poshtë, të gjitha komunat partnere kanë hartuar dhe buxhetuar PLV-të e tyre. Sidoqoftë, vetëm tre nga tetë kanë bërë planifikim buxhetor për vitin 2019 dhe dy komunat partnere, Obiliqi dhe Lipjani, kanë ndarë fonde për zbatimin e PLV-së për vitin 2019. Komunat e tjera kanë shprehur interes për të alokuar fonde për aktivitetet që shkojnë drejt zbatimit të PLV-ve të tyre

	PLV është hartuar dhe aprovuar nga Kuvendi Komunal?	Buxheti i përgjithshëm i PLV-së 2018-2022	Planifikimi i buxhetit për PLV-në për vitin 2019	Komuna ka alokuar fonde / buxhet për zbatimin e PLV-së për vitin 2019?	Nëse PO, tregoni vlerën	Është formuar Komisioni Komunal i Veprimit i PLV-së?
Gjakovë/Đakovica	PO	€ 878,250.00	€ 164,280.00	JO	NUK APLIKOHET	PO
Gračanica/Gračanicë	PO	€ 323,140.00	NUK APLIKOHET	JO	NUK APLIKOHET	PO
Mitrovica/Mitrovica South*	PO	€ 46,320.00	NUK APLIKOHET	JO	NUK APLIKOHET	PO
Lipjan/Lipljan	PO	€ 428,450.00	€ 108,759.00	PO**	€ 20,000.00	PO
Fushë Kosovë/Kosovo Polje	PO	€ 956,400.00	NUK APLIKOHET	JO	NUK APLIKOHET	PO
Ferizaj/Uroševac	PO	€ 1,345,840.00	€ 332,710.00	JO	NUK APLIKOHET	PO
Istog/Istok	PO	€ 101,400.00	NUK APLIKOHET	JO	NUK APLIKOHET	PO
Obiliq/Obilić	PO	€ 762,167.00	NUK APLIKOHET	PO	€ 20,000.00	PO

* PLV i vlefshëm për 2016-2019

** Fondet e alokuara për banim

3. Të gjeturat

3.1. Arsimimi

3.1.1. Vlerësimi i nevojave të komunës në arsim

a) Projektet e përmirësimit të infrastrukturës shkollore

Shumica e komunave partnere (pesë nga tetë: Gjakova, Graçanica, Mitrovica e Jugut, Fushë Kosova dhe Ferizaj) kanë raportuar projekte për përmirësimin e shkollës, të përfunduara në tre vitet e fundit. Obiliqi ka raportuar një projekt komunal në fshatin Palaj që do të zbatohet së shpejti. Lipjani dhe Istogu kanë raportuar se në komunat e tyre përkatëse, nuk e kanë përfunduar asnjë projekt për përmirësimin e shkollës në tre vitet e fundit. Lipjani ka deklaruar se kjo vjen për shkak të kufizimeve buxhetore, ndërsa, Istogu edhe pse kanë pranuar se janë angazhuar në përmirësimin e infrastrukturës shkollore, nuk kanë dhënë një arsytim se pse asnjë projekt i përmirësimit të shkollës nuk ka ndodhur në tre vjet të fundit.

Komunat partnere që kanë raportuar përfundimin e projekteve për përmirësimin e shkollës në tre vitet e fundit, gjithashtu kanë raportuar se kanë marrë fonde të BE-së për këto projekte, me përjashtim të Komunës së Ferizajt / Uroševac, e cila ka marrë fonde nga Ambasada e SHBA-së.

b) Trajnimi i mësuesve

Me përjashtim të Graçanicës dhe Lipjanit, të gjitha komunat e tjera partnere kanë raportuar përfundimin e aftësisimit të mësuesve në tre vitet e fundit. Graçanica ka raportuar se ata nuk kanë asnjë informacion mbi aftësimin e mësuesve duke marrë parasysh që kjo veprimtari është plotësisht nën administrimin e Ministrisë së Arsimit në Serbi. Ndërsa, Lipjani ka raportuar se aftësimi i mësuesve nuk është i përfshirë në buxhetin komunal.

Gjakova, Mitrovica e Jugut, Fushë Kosova dhe Istogu kanë marrë fonde të BE-së për trajnimin e mësuesve të përfunduar në tre vitet e fundit.

c) Ndërmjetësit (mediatorët) e shkollës aktive në komunitetin rom

Me përjashtim të Komunës Ferizajt dhe Komunës së Graçanicës, të gjitha komunat e tjera kanë raportuar ndërmjetësues të shkollave aktive në komunitetin rom. Graçanica ka dhënë udhëzime për të kërkuar këtë informacion në departamentet përkatëse të shkollave fillore dhe të mesme ku përfaqësohen përfaqësuesit e komunitetit rom.

Nga ana tjetër, nga komunat që raportuan ndërmjetësues të shkollës aktive në komunitetin rom, Mitrovica e Jugut kryeson listën me numrin më të madh të ndërmjetësve të shkollës (55 gjithsej: 40 në arsimin profesional dhe 15 në braktisjen e shkollës), pasuar nga Lipjani dhe Istogu, secila me nga 10 ndërmjetësues shkollore. Gjakova ka numrin më të ulët të ndërmjetësve të shkollës (2).

d) Programi i ndihmës komunale për shkolla me fëmijë romë

Me përjashtim të Obiliqit, të gjitha komunat e tjera kanë raportuar financimin e programeve mbështetëse për shkollat me fëmijë romë. Programet mbështetëse janë të ndryshueshme në komuna përkatëse. Për shembull, Lipjani mbështet pjesërisht duke financuar hapësirat për Qendrat e Mësimin, ndërsa Graçanica përveç ofrimit të mbështetjes financiare dhe logjistike për Qendrën Arsimore Romë, ata gjithashtu ofrojnë mbështetje me udhëtime shkollore, ngrohje, veprimtari shkollore dhe sportive dhe shtypjen e materialeve. Nga ana tjetër, Istogu ka raportuar një qasje më multidisiplinare duke treguar mbështetje me programet në fushat e parandalimit të braktisjes, regjistrimit në shkollë dhe ndërgjegjësimin dhe mbështetje financiare për shoqërinë civile të

angazhuar në këto fusha. Në këtë drejtim, në Fushë Kosovë / Kosova Polje, programet për shkolla me fëmijë romë janë financuar këtë vit nga OJQ-ja e VORAE.

e) Drejtoritë kryesore lokale për çështje arsimore

Të gjitha komunat kanë raportuar që departamenti kryesor për këtë fushë është Departamenti i Edukimit, përgjegjës për hartimin e politikave arsimore gjithëpërfshirëse. Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim gjithashtu janë shënuar si zyra të duhura referimi në fushën e arsimit në komunitet.

f) Adresimi i çështjeve të arsimit në nivelin lokal

Të gjitha komunat kanë raportuar që çështjet e arsimit mund të adresohen në nivelin lokal. Në nivelin lokal, çështjet e arsimit mund të adresohen përmes Planeve Lokale të Zhvillimit, Rregulloreve, Planeve të Arsimit Komunal, PLV-ve dhe konsultimeve me shoqërinë civile.

g) Kapacitetet komunale në hartimin dhe zbatimin e projekteve arsimore

Gjysma e komunave partnere (Mitrovica e Jugut, Fushë Kosova, Istogu dhe Obiliqi) kanë raportuar nevojën për ndërtimin e kapaciteteve në ngritjen e fondeve. Lipjani dhe Gjakova kanë raportuar se ato kanë aftësi në hartimin dhe zbatimin e projekteve arsimore, në rastin e kësaj të fundit, është raportuar me kapacitet të lartë. Graçanica pranon projekte në një format të gatshëm të zhvilluar nga një ekip ekspertësh të jashtëm dhe i zbaton ato në përputhje me mjetet buxhetore të mundshme.

Në përgjithësi

Në përgjithësi, komunat partnere dallojnë në nivelin e:

- Njohuri për projektet e zbatuar dhe të dhënat e komunitetit
- Mënyrën e bashkëpunimit me OJQ-të dhe ndërmjetësuesit/mediatorët
- Ndërgjegjësimin për nevojën për ndërtimin e kapaciteteve

Për të përmbledhur, megjithëse ky aktivitet kishte për qëllim vlerësimin e nevojave të komunave partnere, kur analizohen përgjigjet, nevojat komunale për arsimimin e romëve përfaqësohen në formulime të gjera dhe të paqarta, gjë që në rastin më të mirë tregon mungesë kreativiteti të zyrtarëve komunal drejt politikave komunale, dhe në rastin më të keq, mungesën e të kuptuarit të fushës së çështjes me të cilën merren dhe / ose aftësisë për të ofruar një zgjidhje me burime ndonjëherë të kufizuara financiare dhe njerëzore.

3.1.2. Vlerësimi i nevojave të komunitetit në arsim

a) Çështjet kryesore

Analiza ka dhënë vështirësitë që janë paraqitur nga përfaqësuesit e komunitetit, kështu që janë grupuar në pesë kategori të gjera.

Situata ekonomike: Anëtarët e komunitetit raportuan financat si një pengesë kritike për arsimin. Për mungesë të financave, studentët nuk janë në gjendje të ndjekin, me disa dallime nëpër komuna, të gjitha nivelet e arsimit nga parashkollori deri në atë terciar. Raportohet se sistemi i kuotave për studentët e Universitetit është keqpërdorur në dëm të studentëve të komunitetit dhe bursat mungojnë. Blerja e materialeve shkollore, siç janë uniformat shkollore, librat etj., po e vështirësojnë situatën ekonomike të komunitetit rom. Qëndrueshmëria e Qendrave të Komunitetit/Mësimin raportohet si një çështje shqetësuese.

Gjuha: Gjuha është një tjetër pengesë kryesore e raportuar për arsimin e nxënësve romë në përgjithësi. Raportohet se romishtja nuk mësohet në shkollë. Për më tepër, nxënësit romë në disa raste kanë vështirësi në zotërimin e gjuhëve jo-amtare të shkollimit (qoftë shqip ose serbisht). Kjo shkaktohet kryesisht në raste kur flitet gjuhë tjetër brenda familjes, d.m.th. romë apo edhe ndonjë tjetër, dhe në shkollë mësohet në një gjuhë tjetër. Ka pasur raste kur fëmijët e kthyer nga vendet evropiane dhe fëmijët e zhvendosur brenda vendit, të cilët e kanë të vështirë të regjistrohen në shkollat lokale për shkak të pengesave gjuhësore. Ka një mungesë të raportuar të materialeve shkollore. Shkalla e lartë e analfabetizmit në komunitet raportohet, veçanërisht në mesin e femrave të reja, shoqëruar me analfabetizmin e prindërve dhe vetëdijën e tyre [për mungesë] të rëndësisë së arsimit.

Kufizimet sistemike: Raportohet se në përgjithësi mësuesit nuk janë të interesuar të bëjnë përpjekje shtesë me nxënësit romë. Për më tepër, u raportua diskriminim në të gjitha nivelet, si dhe një raport i një rasti të ndarjes së fëmijëve në një shkollë fillore, përkatësisht shkollës Sveti Sava në Obiliq. Megjithatë çështja u trajtua nga departamenti i arsimit, ndarja është ende e diskutueshme midis komunitetit dhe shkollës. Në nivelin institucional, u vërejt se kriteret janë shumë të larta dhe duhet të ulen për regjistrim në shkollë të mesme dhe universitet, si dhe për bursa universitare. Raportohet se Romët nuk janë përfshirë në vendimin e Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për të shtuar pesë nxënës në çdo shkollë të mesme të cilët nuk i plotësojnë kriteret për regjistrim. Nga ana tjetër, u raportua se nuk ka mbështetje për ndërmjetësuesit dhe nuk ka infrastrukturë shkollore, përfshirë nivelin parashkollor. Në njërin komunë raportohet se nuk ka tokë publike në dispozicion për të ndërtuar shkollë në afërsi të komunitetit.

Braktisja e shkollimit: Braktisja e shkollës raportohet në arsimin fillor dhe të mesëm. Kryesisht lidhet me gjendjen financiare të nxënësit. Përfaqësuesit e komunitetit nga shumica e komunave partnere kanë raportuar braktisjen e shkollës si një nga pengesat kryesore për arsimimin e komunitetit rom, në disa raste për shkak të mungesës së bursave dhe mbështetjes institucionale, dhe mungesës së perspektivës në punësim.

Siguria dhe lëvizshmëria: Mungesa e ndihmës për transport për studentët romë në disa nga komunat partnere u raportua se ishte një tjetër pengesë në arsim. Në disa raste, nxënësit romë duhet të ecin në distancë të gjatë për të shkuar në shkollë, duke u përballur me rrezik nga lëvizja e trafikut dhe qenve endacakë.

b) Përgjigja institucionale e shprehur përmes investimeve ose veprimtarisë

Komuniteti ka raportuar disa raste të investimeve ose aktiviteteve të fundit të ndërmarra nga institucioni përkatës komunal në fushat e paraqitura më poshtë:

- Pajisjet shkollore
- Lehtësira për qendrat mësimore, libra shkollore
- Arsim i mesëm intensiv për 18 muaj për 20 nxënës⁵
- Kampe verore
- Një institucion parashkollor (megjithatë fizikisht e paarrtshme për shkak të distancës nga komuniteti)⁶
- Transporti vetëm për të kthyerit

⁵ Projekti i zbatuar në bashkëpunim me Këshillin Danez të Refugjatëve.

⁶ Raportuar në Fushë Kosovë.

- Mësim intensiv të gjuhës shqipe për të kthyerit romë, të cilët po ndjekin sistemin arsimor serb⁷

c) Nevojat/kërkesat e komunitetit rom

Në përmbledhje:

- Transport për nxënësit romë që ndjekin arsimin fillor dhe të mesëm në distancë të caktuar
- Sigurimi i pajisjeve shkollore dhe librave shkollorë
- Ulja e kriterëve të regjistrimit për nivele më të larta të shkollimit (përfshirë parashkollorin)
- Më shumë bursa (për të gjitha nivelet e arsimit)
- Një sistem kuotash që menaxhohet si duhet
- Punësim për të diplomuarit në Fakultetin e Edukimit, për të shërbyer si rol modele
- Qëndrueshmëri për Qendrat e Komunitetit/Mësimin
- Kurse/mësim të gjuhës shqipe
- Mosdiskriminim brenda dhe jashtë shkollës
- Më shumë ndërmjetësues aktiv
- Shkollat dhe parashkollorët të ndërtohen në zonat ku shkollat janë në distancë fizike me komunitetin
- Kurse shkrim-leximi për gratë
- Të ndryshojë vendimin e MASHT-it në lidhje me kriteret e regjistrimit për arsimin e mesëm për të përfshirë romët
- Kurse/mësim të gjuhës serbe

d) Pengesat për plotësimin e nevojave / kërkesave

Në përmbledhje:

- Fondet e bursave përdoren për nevoja shtëpiake (të tilla si ushqim, ngrohje, etj.)
- Sistemi i kuotave universitare për arsimin e lartë është diskriminues për romët
- Vullneti politik në nivelin lokal dhe mungesa e interesit për t'u marrë me arsimin e romëve
- Mungesa e vetëdijes së prindërve për vlerësimin e arsimit
- Diskriminimi dhe stigmatizimi në shkolla
- Nevoja për aktivitete shtesë kurrikulare nga ana e mësuesve nuk adresohet
- Mungesa e fondeve për projekte arsimore (përfshirë ndërmjetësuesit dhe Qendrat e të mësuarit)
- Situata socio-ekonomike e familjeve romë
- Mungesa e informacionit
- Sistemi paralel (arsimi dhe mirëqenia sociale⁸)

e) Zgjidhje të mundshme

Në përmbledhje:

- Sigurimi i bursave për studentët e terciar/universitar (duke ulur kriteret e pranueshmërisë, d.m.th. mesatare e klasës 7.5)
- Niveli më i lartë i përgjegjësisë në administrimin e sistemit të kuotave universitare
- Rekrutimi i ndërmjetësuesve nga komuna dhe aktivitetet e ndërgjegjësimin për prindërit

⁷ Reportuar në Obiliq.

⁸ Komuniteti Rom që ndjek arsimin paralel në gjuhën serbe ka të drejtë për ndihmë të mirëqenies sociale nga Qeveria e Serbisë. Kjo nga ana tjetër krijon një nxitje financiare për romët që të ndjekin arsimin në gjuhën serbe. Edukimi në gjuhën serbe krijon vështirësi që romët të kalojnë në sistemin në gjuhën shqipe, qoftë për studime terciare apo punë.

- Komuna të sigurojë mbështetje me transportimin dhe pajisjet shkollore
- Zbatimi i Ligjit mbi Diskriminimin dhe aktivitetet e ndërgjegjësimit për menaxhimin e shkollës, mësuesve dhe nxënësve
- Komuna të organizoj mësim intensiv për nxënësit që braktisin shkollimin fillor dhe të mesëm
- Angazhimi i komunitetit në monitorimin e çështjeve të braktisjes dhe roli më aktiv i Këshilit të Pirndërve
- Planifikimi buxhetor për Qendrat e Komunitetit/Mësimin dhe mbështetje tjetër që ka implikime financiare (p.sh. paisje shkollore, uniforma, etj.)

Në përgjithësi

Raportohet se komuniteti nuk po merr pjesë në vendimmarrje për çështje arsimore në ndonjë mënyrë thelbësore, e cila mund të interpretohet si përjashtim institucional. Kjo situatë përkeqësohet më tej nga diskriminimi dhe stigma me të cilën nxënësit romë përballen brenda dhe jashtë klasës.

Pothuajse kundërintuitiv kur krahasohet me thirrjen për mosdiskriminim, ekziston gjithashtu një nevojë e përcaktuar qartë për veprim pozitiv (diskriminim pozitiv) në fushën e arsimit për romët. Ky veprim afirmues do të kërkonte të vendoset një sistem kuotash për nxënësit romë në të gjitha nivelet e arsimit (parashkollor në universitet), të ulnen kriteret për regjistrim dhe të sigurohen bursa.

Bazuar në raportet e Vlerësimit të Nevojave të Komunitetit, ndërmjetësuesit po luajnë një rol jetësor në koordinim, komunikim, shkëmbim informacioni dhe komunikim me komunitetin. Komunitet janë thirrur të financojnë pagat e tyre dhe të mbështesin veprimtarinë e tyre. Për më tepër, autoritetet lokale gjithashtu janë thirrur në veprim për adresimin e çështjeve që lidhen me gjuhën shqipe (Obiliq).

Raportohet një mungesë e perspektivës. Nxënësve romë u mungon motivimi sepse nuk shohin një perspektivë të të punësuarve në një punë me kohë të plotë në të ardhmen. Për ta bërë edhe më të vështirë këtë problem është edhe çështja e braktisjes së shkollimit të cilët për mungesë të financave dhe/ose mbështetjes institucionale nuk janë në gjendje të përfundojnë arsimimin e tyre. Propozohet që rol modelët e komunitetit dhe takimet e rregullta ndërgjegjësimi do të ndikojnë pozitivisht në përmirësim të situatës.

Kur krahasohen perceptimet për përgjigjen institucionale dhe perceptimet e çështjeve kryesore që prekin arsimin, siç paraqiten nga Komuniteti, duket se ka një mospërputhje. Përkatesisht, çështjet që prekin arsimin paraqiten të jenë shumë më të mëdha dhe më të thella në fushëveprim kur krahasohen me veprimtarinë institucionale si përgjigje për adresimin e këtyre çështjeve.

3.2. Punësimi

3.2.1 Vlerësimi i nevojave të komunës në punësim

Graçanica pjesën e punësimit e ka lënë pjesën të zbrazët, nën arsyetimin se punësimi nuk bën pjesë në kontrollin e kompetencave të tyre, kështu që këtu përjashtohet nga analiza VKNK-së e fushës së punësimit.

a) Projektet komunale në zhvillimin e aftësive dhe punësimit

Të gjitha komunat partnere kanë raportuar të kenë zbatuar një projekt punësimi në tre vitet e fundit. Komuna e Lipjanit, Fushë Kosovës dhe Obiliqit kanë kontrata aktuale për punë sezonale në mirëmbajtje.

Komuna e Gjakovës, Mitrovicës së Jugut dhe Istogu kanë raportuar projekte që përfshijnë zhvillimin e aftësive. Komuna e Mitrovicës së Jugut ka mbështetur inkubimin e 20 bizneseve. Nga ana tjetër,

komuna e Gjakovës dhe Istogut i kanë mbështetur gjithashtu edhe te kthyerit me aktivitetet e zhvillimit të aftësive.

Nga shtatë komunat partnere që kanë raportuar përfundimin e projekteve në zhvillimin e aftësive dhe punësimin në tre vitet e fundit, vetëm tre komuna kanë raportuar se kanë marrë fonde të BE-së për këto projekte (Gjakova, Mitrovica e Jugut dhe Ferizaj).

Në mënyrë të ngjashme, vetëm tri komuna kanë raportuar pranimin e fondeve jotë BE-së⁹ për këto projekte, përkatësisht komunat Gjakova, Ferizaj dhe Obiliqi.

Këto projekte raportohet se janë zbatuar nga agjencitë komunale të punësimit (Gjakovë / Fushë Kosovë) dhe OJQ-të në Mitrovicën e Jugut. Në Ferizaj, raportohet se ky projekt për të kthyerit romë zbatohet bashkërisht ndërmjet komunës dhe IOM-it.

Gjakova ka raportuar numrin më të madh të përfituesve (40), ndërsa Obiliqi ka raportuar numrin më të ulët të përfituesve (2). Lipjani dhe Ferizaji kanë raportuar 15 përkatësisht 13 përfitues.

b) Drejtoritë kyçe lokale për çështjen e punësimit

Qendrat e punësimit dhe Agjencia e Punësimit janë cilësuar si departamentet më të rëndësishme për çështje punësimi. Për më tepër, departamentet komunale, OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare gjithashtu është raportuar të kenë kompetencë në lidhje me çështjet e punësimit.

c) Adresimi i çështjeve të punësimit në nivelin lokal

Shumica e komunave partnere kanë raportuar se çështjet e punësimit nuk mund të adresohen në nivel lokal. Propozohet që nëse komuna do të bëjë një marrëveshje me Agjencinë e Punësimit, çështjet e punësimit mund të lehtësohen në nivelin lokal.

d) Municipal capacities in designing and implementing employment projects

Shumica e komunave (Gjakova, Lipjani, Fushë Kosova, Ferizaji dhe Obiliqi) kanë raportuar aftësi të mesme për hartimin dhe zbatimin e projekteve të punësimit. Komunat e tjera kanë mirëpritur trajnime shtesë në këtë fushë.

Në përgjithësi

Bazuar në raportet e vlerësimit nga komunat partnere, puna sezonale në shërbimet e pastrimit është forma kryesore e punësimit për komunitetin rom. Për më tepër, autoritetet lokale e shohin veten si jo kompetente për t'u marrë me punësimin për romët dhe mbështeten në udhëzimet e autoriteteve qendrore për politika dhe fonde në fushën e punësimit të romëve. Në përgjigjen e tyre, komunat partnere mbajnë një qëndrim të përgjithshëm se komuniteti rom nuk është i interesuar të trajnohet ose të punësohet, pa marrë parasysh faktorët që mund të kenë sjellë këtë situatë.

Nga ana tjetër, megjithëse komunat partnere kanë realizuar projekte punësimi për komunitetin rom, ata kërkojnë më shumë ndërtim të kapaciteteve në këtë fushë, si dhe qasje të reja, ato më proaktive në trajtimin e punësimit të romëve.

⁹ GIZ, UNDP, USAID, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe Zëri i RAE.

3.2.2. Vlerësimi i nevojave të komunitetit në punësim

a) Çështjet kryesore

Për qëllim të analizës, pengesat që u paraqitën nga përfaqësuesit e komunitetit janë grupuar në tri kategori të gjera.

Diskriminimi: përfaqësuesit e komunitetit kanë raportuar mungesë të mundësive të punësimit për shkak të diskriminimit. Diskriminimi reflektohet në mënyra të ndryshme duke filluar me moszbatimin e kuotës së punësimit prej 10% por edhe në formën e diskriminimit social në sferat publike dhe private. Situata përkeqësohet nga privatizimi i shërbimeve në sektorin publik i cili tradicionalisht ka qenë zona në të cilën komuniteti rom ka marrë punë (p.sh. shërbime të pastrimit dhe mirëmbajtjes). Sipas përfaqësuesve të komunitetit kjo situatë nuk ndihmohet nga përfaqësuesit politikë romë të cilët nuk po marrin një rol më proaktiv në fushën e punësimit të romëve.

Shkollimi: është një nga çështjet kryesore të raportuara për punësimin e romëve. Nxënësit romë për shkak të gjendjes financiare nuk janë në gjendje të ndjekin shkollimin. Për më tepër, është raportuar se punësimi ndikohet nga mungesa e arsimit profesional dhe aftësimin të romëve. Për më tepër, sistemi arsimor nuk po punëson mësues romë në shkolla. Një çështje tjetër kryesore për punësimin është gjuha, pasi raportohet se romët që mbarojnë arsimin e mesëm serb kanë vështirësi të kalojnë nga arsimi parauniversitar i gjuhës serbe në vendet e punës ku flitet shqip.

Mungesa e mbështetjes institucionale: raportohet se ndikon në punësim sepse nuk ka mbështetje për bizneset e vogla nga autoritetet komunale (përfshirë gratë sipërmarrëse). Përndryshe, autoritetet nuk po japin subvencione pagash për punësim në sektorin privat kur punësojnë punonjës romë, duke krijuar kështu stimulime për punësimin e më shumë romëve. Kjo situatë shoqërohet me mungesën e mundësive të praktikës për komunitetin rom dhe përveç kësaj, ka mungesë të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit për mundësitë e punësimit. Raportohet se asnjë rom nuk është i punësuar përmes Qendrave të Punësimit.

b) Përgjigja institucionale e shprehur përmes investimeve ose veprimtarisë

Komuniteti raportoi disa raste të investimeve ose aktiviteteve të fundit të ndërmarra nga institucionet përkatëse komunale në fushat e paraqitura më poshtë:

- Një projekt shumë i shkurtër i subvencioneve të pagave për sektorin privat
- OJQ-të kanë mbështetur disa programe për punë praktike dhe punësimin sezonal
- Disa trajnime të ofruara për gratë romë në trajnime profesionale dhe biznese të vogla, por kualifikimet e tyre janë vërtet të ulta
- Të kthyerit janë përfituesit e vetëm për kurset e gjuhës shqipe

c) Nevojat / kërkesat e komunitetit rom

Në përmbledhje:

- Ligji për kuotën e punësimit duhet të zbatohet dhe institucionet të cilët zbulohen se e kanë shkelur këtë ligj që duhet të sanksionohen
- Siguria në punë për romët në shërbimet (ndërmarrjet) e privatizuara, duke siguruar kontrata pune
- Subvencione në paga si një nxitje për punësimin e romëve në sektorin privat
- Luftimi i diskriminimit në punësimin e romëve
- Ndryshimet në ligje për të përfshirë uljen e taksave për kompanitë që punësojnë romët
- Mundësitë e praktikës dhe punësimit të të rinjve romë në sektorin publik dhe privat
- Më shumë trajnime profesionale (posaçërisht për gratë)

- Punësimi i studentëve romë në sektorin e arsimit si mësues
- Ndarja me kohë dhe më e mirë e informacionit për mundësitë e punësimit
- Masat afirmative për punësimin e komunitetit rom
- Uljen e kriterëve për gratë për të marr pjesë në trajnime profesionale dhe mbështetje për bizneset e vogla
- Fuqizimi dhe mbështetja e bizneseve të vogël të komunitetit

d) Pengesat për plotësimin e nevojave/kërkesave

Në përmbledhje:

- Mungesa e vetëdijes dhe gatishmërisë së komunave për të zbatuar kuotën e punësimit
- Mungesa e gatishmërisë dhe financave për të mbështetur subvencionimin e pagave për sektorin privat
- Diskriminim nga sektori publik dhe privat
- Paragjykitime ndaj komunitetit Rom
- Mungesa e perspektivës në punësimin e maturanëve romë dhe mungesa e motivimit
- Mungesa e qëndrueshmërisë për iniciativat e sipërmarrjes
- Mungesa e përvojës së punës për shkak të punësimit joformal afatgjatë dhe/ose mungesës së tij

e) Zgjidhjet e mundshme

Në përmbledhje:

- Zbatueshmëria e masave pozitive për punësimin e komuniteteve romë
- Trajnim profesional dhe mësim të përshpejtuar për ata që kanë braktisur shkollimin e mesëm
- Stimulimi i sipërmarrjes përmes subvencionimit të bizneseve të vogla (fondi i veçantë komunal) dhe lirim nga taksat për ata që punësojnë romët në sektorin privat
- Subvencione për pagat e punonjësve Romë në sektorin privat
- Mundësi për bërjen e praktikës për të diplomuarit romë në sektorin publik
- Nevoja për qëndrimin në shkollim deri në diplomim
- Më shumë trajnime profesionale për të rinjtë
- Planifikimi i punësimit të romëve në planet e veprimit komunal dhe përveç kësaj kërkimin e mundësisë së punësimit
- Angazhimi i Këshillave të Punësimit nga komuniteti rom në Qendrat e Punësimit
- Një bazë e të dhënave me të diplomuarit e komunitetit rom dhe profilet e tyre
- Ofrimi i kurseve të gjuhës shqipe për ata që kanë nevojë
- Fushatë ndërgjegjësimi mbi rëndësinë dhe metodat e kërkimit të vendeve të punës

Në përgjithësi

Në një farë mase, diskriminimi po ndikon në punësimin e romëve si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Punësimi i romëve duket se është kryesisht sezonal dhe kryesisht për grumbullimin e mbeturinave. Mungesa e mundësive të praktikës dhe subvencioneve për bizneset e vogla ka një ndikim të mirëfilltë në komunitet. Ligji në Kosovë ka një parashikim të kuotës së punës prej 10% për komunitetet, megjithatë, ky ligj nuk po zbatohet. Pa trajnime, kualifikime të dobëta dhe asnjë mbështetje institucionale, punësimi i romëve përfshihet në një cikël të mbrapshtë. Nuk është për t'u habitur që përfaqësuesit e komunitetit po bëjnë thirrje për një veprim afirmues për të përmirësuar këtë situatë, duke krijuar një ndjenjë të sigurisë dhe qëndrueshmërisë për komunitetin në sektorin e punësimit.

Çelësi i këtij ndryshimi do të jetë vullneti politik i autoriteteve komunale dhe skemat e financave që mbështesin praktikën/stazhin, vendet e reja të punës dhe bizneset e vogla. Për më tepër, sistemi i kuotave duhet të zbatohet me sukses dhe institucionet e gjetura që shkelin ligjin, duhet të sanksionohen; institucioni i Ombudspersonit duhet të përfshihet në këtë proces. Përndryshe, autoritetet e nivelit qendror mund të krijojnë një nxitje për komunat që respektojnë sistemin e kuotave duke siguruar mbështetje shtesë për fonde. Në këtë drejtim, do të duhet të krijohet një fond i veçantë.

Gjuha dhe kalimi në tregun e punës janë shumë të rëndësishme në kontekstin e punësimit. Studentët romë që ndjekin arsimin parauniversitar në gjuhën serbe duhet të kenë mjetet për të kaluar në sektorin e punësimit shqipfolës, përmes sigurimit të kurseve në gjuhën shqipe. Në këtë drejtim, përmirësimi i komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit do të rrisë mundësitë e punëkërkesve romë të motivohen dhe angazhohen. Kjo mund të arrihet përmes ndërmjetësve të komunitetit dhe / ose punonjësve romë në zyrat e komunës.

3.3 Banimi

3.3.1. Vlerësimi i nevojave të komunës në banim

a) Projektet e banimit

Me përjashtim të komunave të Mitrovicës së Jugut, Ferizajt dhe Istogut, të gjitha komunat e tjera partnere kanë raportuar që kanë kryer projekte të banimit në tre vitet e fundit. Ferizaj ka raportuar se 38 apartamente janë ndarë nga komisioni komunal, por për shkak të një ankese, çështja është dërguar në gjykatë. Ndërsa, Mitrovica e Jugut ka raportuar se aktualisht nuk ka kërkesë për strehim për shkak të angazhimit të shtuar në këtë zonë në të kaluarën; aktualisht strehimi nuk është një politikë prioritare, nuk ka fonde në dispozicion për projektet e alokuara të banimit. Istogu ka raportuar projekte të banimit, ku përfituesit ishin 10 nëna beqare të komunitetit shqiptar. Në këtë listë, Gjakova udhëheq me 31 shtëpi të ndërtuara në tre vitet e fundit (mbështetur nga UNHCR, IOM dhe DRC), Obiliqi ka 28 shtëpi (mbështetur nga IOM) dhe Fushë Kosova ka ndërtuar 20 shtëpi (IOM) dhe rinovuar 30 shtëpi (të mbështetur nga VORAE); VORAE po mbështet Komunën e Lipjanit edhe në projekte banimi. Graçanica ka ndërtuar katër (4) projekte banimi, ndërsa punimet në nëntë (9) projekte banimi janë duke vazhduar. Vlen të përmendet, nga përgjigja nuk është specifikuar qartë nëse projektet e banimit ishin për të kthyerit ose komunitetet rezidente të romëve (përfituesit e mirëqenies sociale).

Gjysma e komunave partnere kanë aplikuar për fonde për projekte të strehimit (Gjakova, Graçanica, Mitrovica e Jugut dhe Fushë Kosova). Nga ky grup, vetëm Graçanica ka raportuar se nuk ka pranuar fonde të BE për projektet e banimit. Nga ana tjetër, Obiliqi ka marrë fonde të BE-së për projekte të strehimit, edhe pse nuk ka aplikuar. Donatorët jo-BE kanë mbështetur Graçanicën (Ministria e Administrimit Lokal) dhe Obiliqin (Ambasada e Luksemburgut).

Numri i përfituesve të familjeve romë në projekte të banimit është disi i ngjashëm me Gjakovën (31 familje, 174 anëtarë të familjes), Graçanicën (dy familje), Mitrovicën e Jugut (100 anëtarë të komunitetit), Lipjanin (33 familje) dhe Obiliqin (32 familje të kthyer).

b) Drejtoritë kryesore lokale për çështjet e banimit

Raportohet se ZKKK-të, Departamenti i Urbanizmit, Departamenti i Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale dhe Departamenti i Kadastrës janë departamentet kryesore për referimin ose adresimin e çështjeve të banimit.

c) Adresimi i çështjeve të banimit në nivelin lokal

Shumica e komunave partnere kanë raportuar që çështjet e banimit mund të trajtohen në nivel lokal. Përkundër kësaj, Komuna e Istogut ka raportuar se çështjet e strehimit nuk mund të trajtohen në nivel lokal për shkak të mungesës së tokës publike në dispozicion. Lipjani ka raportuar se çështjet e banimit mund të trajtohen pjesërisht në nivel lokal dhe Obiliqi ka raportuar që grupet e punës mund ta lehtësojnë këtë proces por si komunë ata janë të pakënaqur sepse komuna e tyre po bëhet një "kamp i komuniteteve" që vijnë nga të gjitha pjesët e Kosovës.

d) Kapacitetet komunale në hartimin dhe zbatimin e projekteve të banimit

Të gjitha komunat partnere kanë raportuar se kanë nevojë për ngritje të kapaciteteve në hartimin dhe zbatimin e projekteve të banimit. Kjo për shkak se tradicionalisht këto projekte u zhvilluan dhe u implementuan nga partnerë të jashtëm, ku komunat partnere kishin një rol më të vogël në proces.

Në përgjithësi

Pjesa më e madhe e punës në çështjet e banimit të komunitetit rom bëhet nën iniciativën e organizatave ndërkombëtare dhe donatorëve që punojnë në Kosovë. Çështja e strehimit social për komunitetin rom nuk duket të jetë përparësi për komunat partnere, disa prej të cilave po pretendojnë mungesë të tokës komunale në dispozicion për të adresuar këtë çështje. Me sa duket, çështjet e strehimit që prekin komunitetin rom tejkalojnë disponueshmërinë e tokës dhe legalizimin e pronave të tyre.

3.3.2. Vlerësimi i nevojave të komunitetit në banim

a) Çështjet kryesore

Analiza tregon barrierat që janë paraqitur nga përfaqësuesit e komunitetit, të grupuar në katër kategori të gjera.

Dokumentacioni i pronësisë: përfaqësuesit e komunitetit kanë raportuar që komuniteti rom ka një çështje kryesore me dokumentet kadastrale, mungesën e listës së posedimit dhe dokumentet e tjera të pronësisë që prekin banimin. Në këtë drejtim, legalizimi i pronave të tyre dhe vendbanimeve joformale shihet si një çështje e rëndësishme për banimin¹⁰.

Diskriminimi dhe përjashtimi: kur bëhet fjalë për ndarjen e banesave sociale, raportohet se romët përfitojnë rrallë. Për më tepër, ka raporte kur komuna nuk dëshiron të nënshkruajë një marrëveshje me OJQ-të për ndërtimin e shtëpive për romët dhe në raste të tjera komuna nuk ndërton shtëpi me pretekstin e pamundësisë së tokës publike. Për më tepër, raportohet se shumë shpesh të kthyerit marrin trajtim më të mirë se banorët. Raportohet gjithashtu se në shumë raste më shumë se një familje jeton në një shtëpi, kjo i diskualifikon që të marrin ndihmë të mirëqenies sociale. Lidhur me këtë, apartamentet që janë ndarë nga komuna dhe donatorët e tjerë p.sh. apartamentet në Plemetin tani janë shumë të vogla, sepse në ndërkohë është rritur madhësia e familjeve.

Infrastruktura e dobët: Përfaqësuesit e komunitetit kanë raportuar se në shumicën e zonave të banuara nga komuniteti rom, rrugët nuk janë asfaltuara, ka mungesë ndriçimi dhe kanalizimi, dhe

¹⁰ Përcaktimi i UN-HABITAT i Vendbanimeve Joformale: zonat e banimit ku 1) banorët nuk kanë sigurim të apo posedim të tokës ose banesave ku banojnë, me modalitete që fillojnë nga banimi pa leje deri tek marrja me qira e banimeve joformale, 2) Në lagjet zakonisht mungojnë, ose janë të shkëputura nga shërbimet themelore dhe infrastruktura e qytetit dhe 3) strehimi nuk mund të jetë në përputhje me rregulloret aktuale dhe rregulloret e ndërtesave, dhe shpesh ndodhet në zona të rrezikshme gjeografike dhe mjedisore.

shtëpitë nuk kanë tualete. Në raste të tjera, disa shtëpi kanë nevojë për rinovim dhe në disa raste shtëpitë janë të vendosura në zona afër deponive ilegale.

b) Përgjigja institucionale e shprehur përmes investimeve ose veprimtarisë

Përfaqësuesit e komunitetit kanë raportuar disa raste të investimeve ose aktiviteteve të fundit të ndërmarra nga institucioni përkatës komunal në fushat e paraqitura më poshtë:

- Një familje ka marr një shtëpi nën koncesion për 100 vjet dhe dy të tjera kanë marr materiale ndërtimi
- Programet e asistencës për të kthyerit
- Përdorimi i banesave sociale me kohë të kufizuar dhe marrëveshjet me shkrim¹¹

c) Nevojat / kërkesat e komunitetit rom

Në përmbledhje:

- Të kenë dokumentacionin e pronësisë
- Ndërtimi i shtëpive për familjet në nevojë (çështje sociale)
- Rinovimi i tërësishëm ose i pjesshëm i shtëpive
- Lirimi nga tatimi në pronë
- Qasje në grante për strehim (të lidhura me dokumentacionin)
- Banorët të fitojnë mbështetje të barabartë si të kthyerit
- Shndërrimi i deponive të paligjshme në parqe
- Trajtim i drejtë në ndarjen e banesave sociale
- Akomodimi i vogël pengon casjen në mirëqenien sociale për familjet më të mëdha (ato që janë të banuara nga dy ose më shumë gjenerata)

d) Pengesat për plotësimin e nevojave / kërkesave

Në përmbledhje:

- Mungesa e vullnetit politik për të mbështetur komunitetin Rom dhe interesat politike
- Diskriminimi¹² nga autoritetet komunale dhe mungesa e financave
- Mungesa e dokumentacionit të pronësisë/pronës
- Mungesa e tokës private për ti mundësuar familjeve të mëdha të ndërtojnë njësi të tjera
- Çështje ligjore që prekin pronësinë (tarifat, kontakti me pronarët dhe në rastet kur pronari ka vdekur, marrja e pëlqimit nga të afërmit e gjallë, të cilët shpesh jetojnë jashtë vendit))
- Përqendrimi vetëm te të kthyerit
- Mungesa e tokës së disponueshme publike
- Strehim pa leje në banesat kolektive sociale¹³

e) Zgjidhje të mundshme

Në përmbledhje:

- Ndarja më e mirë e informacionit

¹¹ Ky raport vjen nga Obiliqi, i referohet migrimit të brendshëm të romëve në Kosovë në Obiliq dhe se si ata jetojnë ilegalisht në banesat kolektive. Sipas raportit, komuna i ka ofruar këto apartamente për një kohë të shkurtër jetese dhe tani po i furnizon banorët me marrëveshje me shkrim.

¹² Në këtë rast, diskriminimi ngritet në kontekstin e investimeve në infrastrukturën publike, sikurse mos asfaltimi i rrugëve, mungesa e ndriçimit dhe sistemit të kanalizimit. Përfaqësuesit e komunitetit deklaruan se ata dëshirojnë të shohin një ndryshim ku komuniteti rom trajtohet në mënyrë të barabartë me komunitetet e tjera dhe është pjesë e prioritetëve komunale.

¹³ Migrimi i brendshëm në Obiliq ka çuar në strehimin pa leje në banesat kolektive nga të ardhurit, duke i dhënë një tendosje komunitetit rezident rom.

- Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim të vizitoj komunitetin rom dhe për të identifikuar rastet e strehimit në nevojë
- Komunitat t'u japin tokë rasteve sociale për ndërtimin e shtëpisë
- Përfshirja e një përfaqësuesi të komunitetit rom në panelin përzgjedhës të përfituesve për strehim social
- Rritja e angazhimit të komunitetit rom me autoritetet komunale dhe diskutimit publik, dhe anasjelltas rritja e reagimit të autoriteteve komunale ndaj kërkesave të komunitetit rom
- Autoritetet komunale dhe zyrat kadastrale të gjejnë një zgjidhje për rregullimin e dokumentacionit të pronësisë, legalizimin dhe regjistrimin e pronave (duke përdorur Kroacinë dhe Maqedoninë si shembuj)
- Nënshkrimi i marrëveshjeve me OJQ-të dhe ndërtimin e shtëpive të reja
- Lirimi i komunitetit rom nga tatimi në pronë

Në përgjithësi

Komuniteti rom është i ndikuar nga mungesa e pasurisë dhe dokumenteve të pronësisë. Shumica e shtëpive ku jeton komuniteti rom janë të pajisura me kontrata blerjeje dhe nuk posedojnë dokumentacion pronësie dhe kadastral, siç është lista e posedimit. Përveç diskriminimit, mungesa e dokumentacionit është gjithashtu një arsye kryesore pse ata nuk mund të marrin grante ose mbështetje tjetër për ndërtimin e shtëpive nga donatorët. Zgjidhjet e mundshme do të përfshijnë procesin e legalizimit të pronave të tokës duke përdorur përvojën e Kroacisë dhe Maqedonisë.

Familje të mëdha që jetojnë në një ekonomi të përbashkët familjare po përballen me një mori sfidash. Kjo situatë është përkeqësuar për shkak të mungesës së banesave sociale dhe investimeve në këtë fushë. Komunitat duhet të kenë një listë të familjeve në nevojë dhe të sigurojnë tokë komunale për strehim social. Ekzistojnë një numër i çështjeve të raportuara në lidhje me infrastrukturën, si qasja në ujë të pijshëm, ndriçim në rrugë publike dhe deponitë ilegale.

Nga raportet e vlerësimit, duket se autoritetet dhe donatorët si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror po e bëjnë një diskriminim pozitiv ndaj të krhyerve me strehim, mbështetjen e themelimit të bizneseve fillestare (start-up) dhe llojin tjetër të mbështetjes, që po krijon një përçarje mes të kthyerve dhe banorëve.

3.4 Kujdesi shëndetësor

3.4.1. Vlerësimi i nevojave të komunës në kujdesin shëndetësor

Graçanica e ka lënë bosh sektorin e kujdesit shëndetësor, kështu që këtu përjashtohet nga analiza VKNK-së në fushën e kujdesit shëndetësor.

a) Projektet e kujdesit shëndetësor

Me përjashtim të Gjakovës, të gjitha komunitatet e tjera partnere kanë raportuar projekte të zbatuara në kujdesin shëndetësor në tre vitet e fundit. Vaksinimi dhe/ose aktivitetet e ndërgjegjësimit ishin aktivitetet më të përhapura (raportuar nga Lipjani, Fushë Kosova, Ferizaj, Istogu dhe Obiliqi). Për më tepër, kontrollet sistematike shëndetësore u implementuan në Mitrovicën e Jugut dhe Istog. Komunitatet e Fushë Kosovës dhe Obiliqit kanë raportuar vizita mobile në shtëpi. Aktivitetet e planifikimit familjar u raportuan nga Istogu dhe Obiliqi. Aktivitetet e ndërgjegjësimit për higjienën dhe edukimin shëndetësor u raportuan nga Lipjani, Ferizaj dhe Istogu.

Asnjë komunitet partner nuk ka raportuar pranimin e fondeve të BE-së dhe/ose donatorëve të tjerë (me përjashtim të Obiliqit e cila ka marrë fonde nga OSBE) për projektet e kujdesit shëndetësor.

Vetëm komunat e Lipjanit (mbi 150 fëmijë), Fushë Kosovës (mbi 200) dhe Ferizaj (rreth 1600) ishin në gjendje të sigurojnë një numër të përfituesve romë.

b) Ndërmjetësuesit e kujdesit shëndetësor aktivë në komunitetin rom

Komunat e Fushë Kosovës dhe Obiliqit kryesojnë listën me numrin më të madh të ndërmjetësve aktivë të kujdesit shëndetësor në komunitetin rom, me nga pesë secila. Lipjani dhe Ferizaj kanë nga tre ndërmjetësues secila. Gjakova dhe Istogu kanë nga një ndërmjetësues secila.

b) Departamentet kryesore lokale për çështje të kujdesit shëndetësor

Qendra Komunale për Shëndetin e Familjes dhe Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale janë shënuar si departamente kryesore për çështje të kujdesit shëndetësor.

c) Adresimi i çështjeve të kujdesit shëndetësor në nivelin lokal

Dy komuna partnere (Fushë Kosova dhe Obiliqi) kanë raportuar që çështja e kujdesit shëndetësor nuk mund të trajtohet në nivelin lokal, sepse kujdesi shëndetësor nuk është nën kompetencat komunale.

d) Kapacitetet komunale në hartimin dhe zbatimin e projekteve të kujdesit shëndetësor

Me përjashtim të Istogut, të gjitha komunat e tjera kanë raportuar një nevojë për ngritje të kapaciteteve në hartimin dhe zbatimin e projekteve të kujdesit shëndetësor. Istogu ka raportuar të ketë një personel të kualifikuar mjekësor që është i trajnuar në këtë temë, megjithatë, ngritja e kapaciteteve për hartimin e project propozimeve do të ishte e mirëpritur.

Në përgjithësi

Bazuar në raportet e vlerësimit, komunat partnere duket se kanë një marrëdhënie të fortë me ndërmjetësuesit e kujdesit shëndetësor aktivë në komunitetin rom. Raportohet se puna me ndërmjetësuesit do të rezultojë në përmirësimin e komunikimit ndërmjet autoriteteve komunale dhe komunitetit rom. Disa komuna partnere e konsiderojnë kujdesin shëndetësor si çështje thelbësore për politikë dhe veprim. Komunat e mbetura partnere duket se janë të pasigurt se çfarë mund të bëjnë në nivelin lokal për të adresuar çështjet e kujdesit shëndetësor për komunitetin rom.

3.4.2. Vlerësimi i nevojave të komunitetit në kujdesin shëndetësor

a) Çështjet kryesore

Pengesat që u paraqitën nga përfaqësuesit e komunitetit grupohen në tre kategori të gjera.

Mungesa e barnave dhe shërbimeve të kujdesit shëndetësor: përfaqësuesit e komunitetit kanë raportuar se mungesa e barnave është një çështje serioze. Shoqëruar me këtë, qendrat e kujdesit shëndetësor nuk janë në afërsi të zonave të komunitetit dhe nganjëherë ata nuk kanë mjekë të specializuar në detyrë. Raportohet gjithashtu se ka mungesë të shërbimeve të kujdesit shëndetësor për kontrole të rregullta, veçanërisht për gratë e komunitetit (p.sh. gjinekologji, mamografi, etj.) Dhe vizitat në shtëpi për sëmundje serioze që nuk mund të merren në qendrën shëndetësore nuk janë ofruar.

Diskriminimi në qendrat shëndetësore: përfaqësuesit e komunitetit kanë raportuar diskriminim në qendrat shëndetësore. Kjo manifestohet përmes pakujdesisë dhe trajtimit të padrejtë të komunitetit rom, dhe në disa raste disa qendra shëndetësore në afërsi të lagjeve rome emërtohen si "Qendra e kujdesit shëndetësor e maxhupëve".

Shkëmbimi i informacionit: përfaqësuesit e komunitetit raportuan se ka mungesë të broshurave të kujdesit shëndetësor dhe informacione të tjera lidhur me shëndetin, të dhëna komunitetit rom, konkretisht rasti për Romët që përdorin sistemin paralel të shëndetit serb. Për më tepër, raportohet gjithashtu se ekziston një numër i ulët i ndërmjetësuesve të kujdesit shëndetësor që do të lehtësonin shkëmbimin e informacionit dhe komunikimin ndërmjet komunitetit dhe autoriteteve komunale/institucioneve të kujdesit shëndetësor, duke reflektuar në rastet e romëve që përdorin sistemin shëndetësor të Kosovës.

b) Përgjigja institucionale e shprehur përmes investimeve ose veprimtarisë

Përfaqësuesit e komunitetit kanë raportuar disa raste të investimeve ose aktiviteteve të fundit të ndërmarra nga institucioni përkatës komunal në fushat e paraqitura më poshtë:

- Vizitat në shtëpi për vaksinimin e fëmijëve
- Vizita neonatale në shtëpi për të porsalindurit
- Suspendimi i stafit mjekësor për shkak të pakujdesisë ndaj pacientëve nga komuniteti rom¹⁴

c) Nevojat / kërkesat e komunitetit rom

Në përmbledhje:

- Të sigurohen barërat falas për pacientët që vuajnë nga sëmundje serioze/kronike
- Disponueshmëria e kontrolleve sistematike mjekësore të lëvizshme/mobile pa pagesë
- Trajtimi i diskriminimit dhe trajtimit të drejtë
- Shërbimet mjekësore të jenë në dispozicion në afërsi të zonave ku jeton komuniteti rom
- Vendosja e mjekëve specialist në afërsi të zonave ku jeton komuniteti rom
- Vizitat në shtëpi për të sëmurët kronikë
- Të ketë ndërmjetësues të mjaftueshëm të kujdesit shëndetësor për t'u siguruar që komuniteti rom ka në dispozicion informacione për kujdesin shëndetësor

d) Pengesat për plotësimin e nevojave / kërkesave

Në përgjithësi:

- Mungesa e financave dhe zbatimit për furnizim me barnat thelbësore nga Ministria e Shëndetësisë
- Mungesa e financave komunale dhe mungesa e interesit politik
- Paragjykime nga stafi i kujdesit shëndetësor ndaj komunitetit rom
- Mungesa e tokës publike për ndërtimin e qendrave të kujdesit shëndetësor
- Sistemi paralel i kujdesit shëndetësor (p.sh. administruar nga Beogradi)

e) Zgjidhje të mundshme

Në përmbledhje:

- Të sigurohen shërbime vaksinimi afër zonave ku jetojnë komuniteti rom
- Vizita javore nga mjekët dhe/ose klinika shëndetësore mobile/lëvizëse
- Ndërgjegjësimi mbi mosdiskriminimin për punonjësit e kujdesit shëndetësor dhe ndërgjegjësimi për raportimin e diskriminimit për komunitetin
- Disponueshmëria e mjekëve të specializuar që janë lehtësisht të çasshëm nga komuniteti rom
- Punësimi i ndërmjetësuesve të kujdesit shëndetësor

¹⁴ Siç është raportuar në Fushë Kosovë.

- Krijimi i fondit komunal për sigurimin e kujdesit shëndetësor dhe barërave për përfituesit e mirëqenies sociale
- Monitorim i rregullt i ofruesve të kujdesit shëndetësor nga autoritetet komunale për çështjet e diskriminimit dhe neglizhencës

Në përgjithësi

Mungesa e ilaçeve dhe / ose pagesa e shërimit (ilaçeve) nga xhepi po prekin veçanërisht anëtarët e moshuar të komunitetit, fëmijët dhe pacientët me sëmundje kronike. Për më tepër, mungesa e pensioneve për të sëmurët pensionitë me sëmundje kronike është një çështje e rëndësishme shëndetësore. Në vend të pensioneve mjekësore, krijimi i një fondi komunal për sigurimin e kujdesit shëndetësor dhe ilaçet për përfituesit e mirëqenies sociale do të ishte një hap i madh në adresimin e një pengese kryesore në kujdesin shëndetësor për komunitetin rom. Mungesa e informacionit dhe ndërmjetësuesit e paguar nga komuna janë çështje të rëndësishme në lidhje me kujdesin shëndetësor për komunitetin rom.

Anëtarët e komunitetit rom shpesh ballafaqohen me diskriminim nga stafi në qendrat shëndetësore në forma të ndryshme, vërehet se gratë rome nuk janë përfshirë në iniciativat për shërbime mjekësore siç është testimi i mamografisë. Fushata ndërgjegjësimi duhet të bëhen ndërmjet komunitetit dhe ofruesve të kujdesit shëndetësor për të kuptuar çështjet e diskriminimit. Kjo situatë rëndohet nga mungesa e qendrave të kujdesit shëndetësor, mjekëve specialistë në zonat e banuara nga komuniteti rom. Një zgjidhje e përkohshme e mundshme janë shërbimet mobile të klinikës shëndetësore, deri sa të ndërtohen qendrat e kujdesit shëndetësor.

3.5 Gjithëpërfshirja

3.5.1. Vlerësimi i nevojave të komunës në gjithëpërfshirje

a) Projektet e barazisë sociale dhe përfshirjes

Vetëm Mitrovica e Jugut dhe Ferizaj kanë raportuar projekte të implementuara për barazi sociale dhe përfshirje në tre vitet e kaluara. E para, në bashkëpunim me OJQ PRAM ka realizuar një projekt shkrimi (shkrim;-exim), ndërsa kjo i fundit, në bashkëpunim me GIZ ka realizuar një projekt për promovimin dhe fuqizimin e shërbimeve sociale. Graçanica dhe Lipjani konsiderojnë se komuniteti rom është i integruar mirë në komunat e tyre përkatëse.

Nga të gjitha komunat partnere, vetëm Fushë Kosova ka raportuar pranimin e fondeve (si BE ashtu edhe jo-BE) për projekte të barazisë sociale dhe gjithëpërfshirjes, megjithëse nuk kanë raportuar të kenë zbatuar ndonjë projekt të tillë.

b) Departamentet kryesore lokale për çështje të barazisë sociale dhe përfshirjes

Departamentet kryesore komunale për barazi dhe përfshirje sociale raportohen të jenë Departamenti për Barazi Gjinore, Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Zyra për Komunitete dhe Kthim, Qendra për Punë Sociale, Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe Departamenti i Arsimit.

c) Adresimi i barazisë sociale dhe çështjeve të përfshirjes në nivelin lokal

Fushë Kosova dhe Obiliqi konsiderojnë se çështjet e barazisë sociale dhe përfshirjes mund të adresohen pjesërisht në nivelin lokal. Lipjani ka raportuar se çështjet e barazisë sociale dhe përfshirjes mund të adresohen në nivel lokal.

d) Kapacitetet komunale në hartimin dhe zbatimin e projekteve të barazisë sociale dhe përfshirjes

Vetëm Lipjani ka raportuar të ketë aftësi në hartimin dhe zbatimin e projekteve të barazisë sociale dhe përfshirjes. Pjesa tjetër e komunave partnere ka raportuar mungesë kapaciteti dhe/ose burime njerëzore. Duke marrë parasysh segregimin e komunitetit rom nën arsyetimin e ekzistimit të sistemit paralel, Obiliqi ka raportuar se barazia sociale dhe përfshirja e romëve nuk bën pjesë në kontrollin e kompetencave komunale.

Në përgjithësi

Bazuar në raportet e vlerësimit, mungesa e projekteve dhe veprimtarisë komunale për barazi sociale dhe përfshirje të romëve bazohet në të kuptuarit e komunave partnere që nuk ka diskriminim dhe se komuniteti rom është i integruar në shoqëri, dhe në disa raste diskriminohet pozitivisht.

3.6 Bujqësia

4.6.1. Vlerësimi i nevojave të komunitetit në bujqësi

a) Çështjet kryesore

Barrierat që u paraqitën nga përfaqësuesit e komunitetit grupohen në dy kategori të gjera.

Mungesa e mbështetjes: Përfaqësuesit e komunitetit kanë raportuar mungesën e subvencioneve si çështjen kryesore për t'u angazhuar në bujqësi. Në rastet kur subvencionet janë në dispozicion, kriteret janë shumë të larta. Për më tepër, mungesa e pajisjeve për bujqësi është një çështje e raportuar për bujqësinë.

Diskriminimi: Përfaqësuesit e komunitetit kanë raportuar diskriminimin si arsye që nuk janë në gjendje të shesin produktet e tyre bujqësore. Ndoshta e lidhur me të dyja çështjet, për atë edhe ekziston mungesa e interesit për të punuar në bujqësi.

b) Përgjigja institucionale e shprehur përmes investimeve ose veprimtarisë

Përfaqësuesit e komunitetit kanë raportuar që institucionet përkatëse komunale kanë ofruar subvencione, por kriteret janë shumë të larta.

c) Nevojat/kërkesat e komunitetit rom

Në përmbledhje:

- Të ketë mbështetje në zhvillimin e biznesit bujqësor
- Të ulen kriteret për subvencione në nivelin lokal dhe qendror
- Të kenë tokë dhe dokumentacion të duhur (pronësi)

d) Pengesat për plotësimin e nevojave / kërkesave

Në përmbledhje:

- Kriteret të larta për grante dhe subvencione në bujqësi për komunitetin rom
- Paragjykimi i popullatës ndaj romëve
- Përfshirja e ulët/mos përfshirja e anëtarëve të komunitetit në panelet përzgjedhëse për subvencione
- Mungesa e tokës, dokumentacionit dhe informacionit në lidhje me programet bujqësore

e) Zgjidhje të mundshme

Në përmbledhje:

- Komuna të sigurojë mbështetje me grante, subvencione dhe pajisje
- Ministria dhe Komunitet t'i ulin kriteret
- Mbështetja edhe për fermerët që kanë tokë me qira
- Pagë më të mirë dhe orari normal i punës në përputhje me ligjin e punës
- Të ketë një përfaqësues Rom në panelin përzgjedhës për grante dhe subvencione
- Komuniteti të përgatisë një bazë të të dhënave për të gjithë romët e angazhuar në bujqësi
- Shkëmbimi më i mirë e informacionit me komunitetin rom dhe mbështetja nga autoritetet komunale
- Zgjidhja e çështjes së dokumentacionit të pasurisë/tokës

Në përgjithësi

Bazuar në raportet e vlerësimit, ka raste të rralla të romëve që posedojnë tokë në zonat rurale. Komuna e Istogut është një nga shembujt ku familjet rome posedojnë dhe punojnë tokën bujqësore. Prandaj, pronësia e tokës është një pengesë për komunitetin rom që të angazhohet në bujqësi. Përveç kësaj, ekziston një nevojë e raportuar për pajisje bujqësore. Puna sezonale (në shërbimet e pastrimit) raportohet të ketë një efekt në bujqësi sepse vera është koha kur të dy kryqëzohen. Për punën sezonale në bujqësi, raportohet se orari i punës është shumë i gjatë, kushtet e punës janë të dobëta dhe përfitimet janë të vogla.

Në rastet kur ka tokë dhe interes për bujqësinë, kriteret janë shumë të larta për komunitetin rom. Ulja e kriterëve, trajnimi dhe shkëmbimi i informacionit do të përmirësonte situatën. Për ata anëtarë të komunitetit që merren me bujqësi, diskriminimi dhe paragjykimet pengojnë shitjen e produkteve të tyre.

3.7 Ngritja e fondeve

3.7.1. Vlerësimi i nevojave të komunës në ngritjen e fondeve

a) Kapaciteti i ngritjes së fondeve

Të gjitha komunat raportuese kanë raportuar se kanë nevojë për ngritje të kapaciteteve për ngritjen e fondeve. Lipjani dhe Obiliqi u drejtohen ndërmarrjeve private kur kanë të bëjnë me ngritje të fondeve.

Ngritja e fondeve raportohet të jetë në kontrollin e kompetencave komunale.

b) Departamentet kryesore lokale për ngritje të fondeve

Departamentet lokale të mandatuara për mbledhjen e fondeve janë Departamenti për Buxhet dhe Financa, Departamenti për Shërbime Publike, Departamenti për Bujqësi, Departamenti për Rini, Sport dhe Kulturë, Zyra Komunale për Komunitet dhe Kthim, Departamenti për Zhvillim Ekonomik, Departamenti i Urbanizmit dhe Zyra e Kryetarit.

Në përgjithësi

Bazuar në raportet e vlerësimit, autoritetet komunale janë të pajisura dobët për t'u marrë me ngritjen e fondeve. Për më tepër, ata kanë raportuar një nevojë për ngritje të kapaciteteve në fushën e shkrimit, zbatimit dhe raportimit të projekteve.

3.8 Të tjera

3.8.1. Vlerësimi i nevojave të komunitetit në të tjera

a) Çështjet kryesore

Për hir të analizës, pengesat që u paraqitën nga përfaqësuesit e komunitetit grupohen në katër kategori të gjera.

Regjistrimi civil: përfaqësuesit e komunitetit kanë raportuar mungesën e dokumentacionit dhe regjistrimit për fëmijët e riatdhesuar si një çështje të rëndësishme. Fëmijët e lindur jashtë Kosovës dhe që asnjëherë nuk janë regjistruar, nuk kanë një certifikatë lindjeje dhe për pasojë nuk kanë dokumente shkollore.

Aktivitetet kulturore: çështje e rëndësishme për përfaqësuesit e komunitetit në fushën e veprimtarive kulturore ishin mungesa e mbështetjes për të rinjtë në aktivitete kulturore dhe sportive, mungesa e ruajtjes së trashëgimisë kulturore. Lidhur me këtë, në disa zona nuk ka qendra të komunitetit ku mund të zhvilloheshin aktivitete kulturore.

Infrastruktura: përfaqësuesit e komunitetit kanë raportuar një numër çështjesh në lidhje me infrastrukturën. Përkatësisht, mungesa e rrugëve të asfaltuara dhe rrugëve të ndriçuara, lidhja me ujësjellësin, kanalizimet dhe rrjeti elektrik (përfshirë tarifat e energjisë elektrike), mungesa e parqeve dhe kopshteve në zonat rurale, deponitë ilegale në afërsi të zonave të banuara nga komuniteti, nuk ka hapësirë të ndarë për dru prerësit dhe, në disa zona, qasja në varreza.

Informacioni dhe komunikimi: mungesa e mbështetjes për radio-programet lokale për komunitetin është një çështje e rëndësishme¹⁵. Për më tepër, ekziston një mungesë e raportuar e komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritetet komunale.

b) Përgjigja institucionale e shprehur përmes investimeve ose veprimtarisë

Përfaqësuesit e komunitetit kanë raportuar disa raste të investimeve ose aktiviteteve të fundit të ndërmarra nga institucioni përkatës komunal në fushat e paraqitura më poshtë:

- Autoritetet dhe OJQ-të po punojnë për regjistrimin civil të fëmijëve romë
- Disa deponi ilegale po pastrohen nga autoritetet locale
- Në një rast, autoritetet komunale kanë bërë një marrëveshje me KEDS për të ndërtuar një transformator elektrik për të përmirësuar qasjen në energji elektrike

c) Nevojat/kërkesat e komunitetit rom

Në përmbledhje:

- Të regjistrohen të gjithë fëmijët në mënyrë që të mos lihen jashtë sistemit shkollor
- Të pastrohen dhe mirëmbahen deponitë sa më shpejt të jetë e mundur
- Rinia të jetë aktive në aktivitete kulturore dhe sportive
- Të asfaltohen dhe të ndriçohen rrugët
- Të kenë qasje në ujë të pijshëm, kanalizim dhe sistemin elektrik
- Më shumë aktivitete për ruajtjen e traditës dhe kulturës rome

d) Pengesat për plotësimin e nevojave/kërkesave

Në përmbledhje:

- Personat që përfitojnë nga biznesi i riciklimit të mbeturinave

¹⁵ Radio programi në gjuhën rome në Graçanicë shërben si një shembull pozitiv.

- Mosgatishmëria politike e komunave për t'u marrë me problemet dhe mungesën e financave
- Mungesa e kopshteve për fëmijë dhe financat për ndërtimin e kopshteve të tilla
- Mosgatishmëria e komunave për t'u marrë me problemet e infrastrukturës

e) Zgjidhje të mundshme

Në përmbledhje:

- Komuna të jetë më efikase në bashkëpunim me CRPK dhe UNHCR në çështjet e regjistrimit civil
- Autoritetet komunale të hartojnë zgjidhje të qëndrueshme për deponitë ilegale
- Autoritetet komunale të ndajnë një vend për prerësit e drurit
- Komuna të ketë një fond të dedikuar për aktivitete kulturore dhe sportive, instrumente muzikore dhe të sigurojnë një strukturë për aktivitete të tilla
- Autoritetet komunale të sigurojnë një hapësirë për një radio stacion për komunitetin
- Angazhimi i më shumë ndërmjetësuesve për t'u marrë me çështjet e regjistrimit civil, komunikimit me komunën dhe shkëmbimin e informacionit
- Autoritetet komunale të sigurojnë një hapësirë për qendrat e komunitetit
- Autoritetet komunale të ndërtojnë kopshte të fëmijëve në zonat rurale
- Qasja në ujë, kanalizim dhe sistem elektrik

Në përgjithësi

Bazuar në raportet e vlerësimit, trajtimi i problemeve të infrastrukturës me të cilat përballet komuniteti rom është një çështje e rëndësishme që duhet të zgjidhet nga autoritetet komunale. Regjistrimi civil i romëve të riatdhesuar do të rrisë mundësitë e regjistrimit të shkollës. Autoritetet komunale gjithashtu duhet të angazhohen dhe financojnë promovimin e veprimtarive kulturore, në lidhje me këtë radiostacionet në komunitet do të ndihmonin në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe shkëmbim të informacionit.

4. Rekomandimet

Raporti i Vlerësimit ofron një përmbledhje fillestare të kapaciteteve dhe nevojave të komuniteteve romë dhe komunave përfituese të Programit ROMACTED në Kosovë. Në kohën kur u hartua ky raport, të tetë komunat partnere të ROMACTED kanë PLV-të me buxhete të zhvilluara, megjithatë, vetëm tre nga tetë kanë bërë planifikim buxhetor për vitin 2019; me komunat e tjera që kanë shprehur interes për mundësinë e ndarjes së fondeve për aktivitetet që shkojnë drejt zbatimit të PLV-ve të tyre në të ardhmen. Bashkëpunimi dhe monitorimi i ardhshëm i komunave partnere do të tregojë nëse këto numra ndryshojnë në të ardhmen, por gjithashtu duket parë kur afrohet afati i zbatimit të PLV-ve, cilat do të jenë rekomandimet dhe sugjerimet nga ana e komunës për sa i përket zbatimit të PLV-së përkatëse.

Në nivelin qendror, bazuar në të dhënat dytësore, Raporti i Vlerësimit konstaton se zbatimi i Strategjisë "mbetet i largët" nga realizimi i aktiviteteve të parashikuara, kryesisht për shkak të mungesës së angazhimit politik, burimeve të pamjaftueshme financiare dhe njerëzore për monitorimin e progresit, dhe koordinim jo korrekt të institucioneve të nivelit qendror dhe atij lokal. elësi për zbatimin e suksesshëm, koordinimin dhe monitorimin e Strategjisë do të jetë funksionimi efektiv i KKV-ve në komunat partnere, dhe planifikimi dhe alokimi buxhetor për secilen nga përparësitë e identifikuar.

Në mbarë Kosovën dhe përtej komunave partnere ROMACTED, studime të tjera të rëndësishme të bëra nga UNDP dhe UNICEF shënojnë një hendek të gjerë midis romëve dhe jo-romëve për sa i përket aftësive njerëzore dhe mirëqenies materiale, dhe boshllëqe të theksuara në privime të rënda materiale, arsim, tregun e punës, shëndetësi dhe banim. Situata përkeqësohet nga mungesa e mekanizmave të këshillimit me bazë në komunitet ose, kur ekzistojnë mekanizma të tillë, përjashtimi i romëve, tokenizmi, përfshirja vetëm e disave, dhe mosbesimi i ndërsjellë midis komunitetit rom dhe institucioneve publike. Një numër i Raporteve të Vlerësimit të Komunitetit të publikuara nga MONK tregojnë se komuniteti rom në Kosovë po përjeton pafuqi, varësi, qëndrim pesimist ndaj perspektivës së të ardhmes, humbje shprese, mungesë aftësie dhe besim. Autoritetet lokale, nga ana tjetër, janë të inkuadruar në mundësinë e vërtetë të një dialogu të vërtetë me komunitetin rom, kanë mungesë njohuri për kulturën dhe traditën romë, janë të mbingarkuar me bollëkun e projekteve dedikuara për romët, dhe kanë njohuri dhe aftësi të kufizuara për të zbatuar demokracinë pjesëmarrëse.

Duke përdorur gjetjet nga VNK dhe VKNK, një numër rekomandimesh relevante dhe shqetësime kritike që prekin komunitetin rom u identifikuan në fushat e arsimit, punësimit, kujdesit shëndetësor, banimit, bujqësisë dhe regjistrimit civil. Ky proces ka identifikuar gjithashtu nevojën për kapacitete si për autoritetet komunale ashtu edhe për përfaqësuesit e komunitetit, dhe nëse adresohen në mënyrë adekuate do të rezultojë në një pjesëmarrje të zgjeruar të komunitetit rom në qeverisjen lokale në Kosovë.

Rekomandimet dhe kufizimet kritike të dhëna më poshtë janë zhvilluar me qëllim të ndihmës së GVK-ve dhe GPI-ve të përqendrojnë vëmendjen e tyre bashkëpunuese në punën e përbashkët për të adresuar çështjet e rëndësishme për komunitetin rom, duke rezultuar në një përmirësim të përgjithshëm të qeverisjes së mirë dhe fuqizimin e komunitetit rom në vend.

Arsimimi

Siç paraqitet në Kapitullin 4, komuniteti Rom përballlet me pengesa të shumta në fushën e Arsimit. Një mori faktorësh socio-ekonomiko-politikë po e mban komunitetin Rom në arritjen e rezultateve më të larta arsimore kolektive.

Për të adresuar kufizimet sistematike në fushën e Edukimit për komunitetin Rom, pa ndryshim në të gjitha komunat partnere ROMACTED, përfaqësuesit nga GVK kanë bërë thirrje për veprim afirmues të **uljes së kriterëve** për nxënësit e komunitetit rom për **regjistrimin në shkollë** (të gjitha nivelet, përfshirë parashkollorin) dhe **bursat universitare**. Ulja e kriterëve të për komunitetin rom do të rezultojë në një efekt të grumbullimit (rritjes së numrit) të nxënësve nga komuniteti rom në shkollë dhe do t'i ndihet në përfundimin e arsimit.

Si masë konkrete, shkalla e regjistrimit të nxënësve të komunitetit rom do të përfitonte nga **përfshirja e komunitetit rom në vendimin e MASHT-it** për regjistrimin vjetor të pesë nxënësve që nuk i plotësojnë kriteret për regjistrim në çdo shkollë të mesme në Kosovë.

Ulja e kriterëve për bursa universitare për studentët romë dhe vendosja e një sistemi të kuotave do të ndihmonte **kundërveprimin e ndikimit të situatës së varfër ekonomike** të komunitetit rom që i parandalon ata të përfundojnë arsimin terciar.

Nga ana tjetër, ka nevojë për më shumë ndërgjegjësim në mesin e prindërve romë për të kuptuar rëndësinë e edukimit të fëmijëve, veçanërisht ndërgjegjësimin për lejimin e arsimit të vajzave. Në këtë drejtim, MASHT, duhet të promovojë edukimin midis komuniteteve romë përmes fushatave të ndërgjegjësimin - aktivitete që tashmë janë përfshirë në Strategji.

Punësimi

Siç raportohet nga GVK-të dhe mbështetur nga sondazhet në mbarë vendin, të bëra nga UNDP dhe UNICEF, punësimi për komunitetin rom është i ndikuar nga diskriminimi në sektorët publik dhe privat, arsimi i ulët dhe kapacitetet, dhe mungesa e mbështetjes institucionale për bizneset e vogla. Në mungesë të veprimeve më të dukshme të politikave, romët vazhdojnë të jenë të angazhuar në punë sezonale në shërbimet publike me kompensim të dobët dhe pa siguri në punë.

Për të përmirësuar situatën e punësimit të romëve, janë paraqitur një numër rekomandimesh për politikën. Kryesisht, komuniteti rom po kërkon **zbatimin e sistemit të kuotave të punësimit 10% për komunitetet**. Kjo politikë do të ndihmonte komunitetin rom të ulë diskriminimin dhe stigmën me të cilën përballen, me qasje të përmirësuar në punësim si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Që ky veprim i politikës të ketë sukses, sistemi i kuotave të punës kërkon monitorim të ngushtë dhe sanksione për ata që gjeten duke e shkelur atë.

Arsimimi dhe aftësimi profesional ndikojnë shumë në punësimin e romëve. Rekomandimi është të sigurohet **punësim afatgjatë për romët i plotësuar me trajnime në vendin e punës**.

Autoritetet komunale këshillohen të mbledhin vullnet politik dhe financat e nevojshme për të zhvilluar një **pako mbështetëse institucionale** për komunitetin rom për t'i mbështetur mundësitë e bërjës së praktikës, trainimit profesional, punësimit dhe subvencionimit të bizneseve të vogla (përfshirë gratë sipërmarrëse). Në një skemë stimuluese, autoritetet qendrore mund të mbështesin nivelin lokal duke siguruar mbështetje me fonde shtesë për komunat që respektojnë sistemin e kuotave të punësimit dhe kanë politika të tjera për punësimin e romëve.

Në koordinim me ndërmjetësuesit e komunitetit dhe/ose zyrtarët komunalë nga komuniteti rom, autoritetet komunale duhet të **përmirësojnë komunikimin që të bëhet shpërndarja e informacion mbi mundësitë e punësimit** për komunitetin rom në komunat e tyre përkatëse. Nga ana tjetër, komunitetet romë duhet të jenë proaktive në kërkimin e informacionit dhe mundësive të punësimit nga institucionet përkatëse vendore.

Banimi

Në Kosovë, komuniteti rom është veçanërisht i prekur nga mungesa e patundshmërisë dhe dokumenteve të pronësisë. Komuniteti Rom jeton në shtëpi me kontrata blerjeje por nuk posedojnë dokumente pronësie dhe kadastrale. Mungesa e dokumentacionit është një nga arsyt kryesore pse romët nuk kanë të drejtë për grante ose lloj tjetër të mbështetjes për ndërtimin e shtëpive nga donatorët.

Rekomandimi për adresimin e çështjes së strehimit për komunitetet romë në një mënyrë më gjithëpërfshirëse është të ndiqen shembujt e **Kroacisë dhe Maqedonisë Veriore në procesin e legalizimit të pronave tokësore për vendbanimet/ekonomite familjare romë**. Procesi i legalizimit prek drejtpërdrejt ekonomitë familjare romë përmes përmirësimit të cilësisë së tyre të jetesës dhe qasjes më të mirë në burimet komunale, si dhe përmes çlirimit të kapitalit për çdo investim të mëtejshëm.

Komunat duhet të kenë një listë të familjeve në nevojë, të cilët jetojnë në njësi të mbipopulluara dhe banesa të varfëra dhe të ofrojnë tokë komunale dhe mbështetje financiare për **projektet e strehimit social dhe investimeve** në zonat e populluara nga komuniteti Rom. Investimi në infrastrukturë do të rrisë mundësinë e përdorimit të ujit të pijshëm, ndriçimit rrugor publik dhe shërbimeve të tjera, duke përmirësuar drejtpërdrejt cilësinë e jetës së banorëve..

Një tryezë e rumbullakët me komunat përfituese ROMACTED do të lehtësonte trajtimin e kësaj teme të rëndësishme me një qasje nga poshtë-lart (të detajuar), ku mund të identifikohen reformat e nevojshme të politikave të banimit dhe t'i propozohen qeverisë qendrore për zbatim.

Kujdesi shëndetësor

Siç është raportuar nga AGTSH e UNICEF-it, komuniteti rom përballet me dallime të mëdha kur krahasohet me komunitetet jo-romë në të gjitha fushat e matjeve shëndetësore. Përfaqësuesit e GVK-ve gjithashtu kanë raportuar mungesë të ilaçeve, në disa raste, diskriminim në qendrat shëndetësore dhe mungesë të shkëmbimit të informacionit si çështje serioze që prekin komunitetin rom në fushën e shëndetësisë.

Rekomandohet që komunat partnere të ROMACTED të konsiderojnë **kujdesin shëndetësor si çështje kryesore për politikë dhe veprim** në përfshirjen e komunitetit rom.

Në vend të përfitimeve mjekësore, krijimi i një fondi komunal për **ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe ilaçeve për përfituesit e mirëqenies sociale** do të ishte një hap i madh përpara në adresimin e një pengese kryesore në kujdesin shëndetësor për komunitetin rom.

Për të përmirësuar komunikimin dhe për të lehtësuar shpërndarjen e informacionit shëndetësor ndërmjet autoriteteve komunale/shëndetësisë dhe komunitetit rom, rekomandohet **angazhimi i ndërmjetësuesve të komunitetit**. Lista e barërave esenciale është e panjohur për shumicën e komunitetit rom. Informacioni mbi listën esenciale të barërave dhe mundësinë e përdorimit të barërave falas duhet t'i ofrohet komunitetit në mënyrë urgjente.

Gjithëpërfshirja

Bazuar në gjetjet nga VKNK, të gjitha komunat partnere ROMACTED kanë shprehur nevojën për ndërtimin e kapaciteteve në hartimin dhe zbatimin e projekteve të barazisë sociale dhe përfshirjes. Arsyeimi për këtë bazohet në mungesën e aftësive dhe / ose burimeve njerëzore.

Rekomandimi është të krijohet një **program gjithëpërfshirës për ndërtimin e kapaciteteve që synojnë zyrat komunale** që janë përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e projekteve të barazisë sociale dhe përfshirjes. Një program i tillë i ngritjes së kapaciteteve do të përfshijë trajnimin e

zyrtarëve komunalë për mjete të ndryshme për pjesëmarrjen sociale, ekonomike dhe politike të grupeve të marginalizuara, buxhetimin dhe zbatimin e projektit, monitorimin dhe raportimin e projekteve të përfshirjes sociale.

Ngritja e fondeve

Bazuar në gjetjet e VKNK, autoritetet komunale janë të pajisura dobët për t'u marrë me ngritjen e fondeve, për shkak të mungesës së aftësive dhe / ose burimeve njerëzore. Për më tepër, IËG nga të gjitha komunat partnere ROMACTED kanë raportuar një nevojë për ngritje të kapaciteteve në fushën e shkrimit, zbatimit dhe raportimit të projekteve.

Rekomandimi është të krijohet një **program i ngritjes së kapaciteteve që synojnë zyrat komunale** që janë përgjegjës për mbledhjen e fondeve për projektet që synojnë komunitetin rom. Me interes specifik, komunat partnere ROMACTED kanë kërkuar ndërtimin e kapaciteteve për të pasur qasje në fondet IPA.

4.1. Kufizimet kritike

Bazuar në gjetjet e VNK dhe VKNK, dhe për qëllimet e Raportit të Vlerësimit, tre kufizime kryesore kritike që kufizojnë përfshirjen e plotë të komunitetit rom në të gjitha aspektet e jetës shoqërore në Kosovë janë identifikuar më poshtë.

Situata ekonomike e komunitetit rom

Një nga pengesat kryesore për përfshirjen e plotë të komunitetit rom në Kosovë është **situata ekonomike. Efektet e situatës ekonomike të varfër të komunitetit Rom duket se ndjehen ndjeshëm në arsim.** Për shkak të mungesës së financave, nxënësi romë nuk janë në gjendje të ndjekin, me disa ndryshime nëpër komuna, të gjitha nivelet e arsimit nga parashkollori në terciar. Blerja e materialeve shkollore po e vështirëson situatën ekonomike të familjeve romë. Kjo situatë si pasojë ka rezultuar në rritje të braktisjes së shkollës në arsimin fillor dhe të mesëm, dhe paaftësinë e nxënësve romë që të mbarojnë studimet e tyre të larta.

Nga ana tjetër, **arsimi është një nga çështjet kryesore që prek punësimin e komunitetit rom.** Për shkak të situatës së varfër ekonomike, të rinjtë romë duhet të braktisin arsimin e tyre dhe të kthehen në aktivitete për krijimin e të ardhurave për të mbështetur familjet e tyre, gjë që ka krijuar sensin e rremë që të rinjtë romë nuk janë të interesuar për arsim dhe aftësim profesional. Në këtë situatë, komuniteti rom ka mundësi të kufizuara për të garuar me sukses në tregun e punësimit në Kosovë, për shkak të disavantazhit sistematik me të cilin përballen për shkak të situatës ekonomike.

Kapaciteti i ulët institucional

Administrata shtetërore në Kosovë po ndërtohet me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë tash e 20 vjet. Kjo reformë e vazhdueshme ka synuar krijimin e institucioneve të përgjegjshme dhe demokratike në Kosovë, në nivelin lokal dhe qendror. Përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve institucionale janë duke treguar përparim në rritje. Pavarësisht, dhe siç sintetizohet nga gjetjet e raporteve të VKNK-së, **kapacitetet institucionale të administratës shtetërore në Kosovë për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të suksesshme që synojnë përfshirjen e plotë të komuniteteve rom në të gjitha aspektet e jetës shoqërore në Kosovë, janë të ulta.** Për më tepër, shumë politika në nivelin lokal nuk janë në përputhje me politikën në nivelin qendror dhe anasjelltas.

Në fakt, nevoja për ndërtimin e kapaciteteve është një reagim i përgjithshëm që kanë treguar të gjitha komunat partnere të ROMACTED gjatë VKNK. Institucionet lokale kanë shprehur nevojë të qartë për të ndërtuar kapacitetet e tyre në ngritjen e fondeve dhe hartimin e politikave/programeve për përfshirjen e komunitetit rom dhe të gjithë qytetarëve në përgjithësi.

Mungesa e buxhetimit në PLV-të

Aktualisht, **vetëm dy nga tetë komunat partnere të ROMACTED kanë bërë alokime buxhetore për vitin 2019 në PLV-të e tyre përkatëse. Në nivelin qendror, nuk ka alokim të qartë të buxhetit për zbatimin e aktiviteteve që vijnë nga Strategjia, dhe deri më tani, nuk ka pasur ndonjë alokim të fondeve për zbatimin e Strategjisë.** Sidoqoftë, raportimi i ZKQM për Strategjinë, ofron një tabelë me shpenzimet financiare të Ministrisë së linjës përkatëse që shkojnë drejt zbatimit të strategjisë.

Megjithëkëtë, u bënë përpjekje të konsiderueshme për të mbështetur përfshirjen socio-ekonomike-politike të komunitetit rom, ende shumë mbetet për të bërë. Në këtë drejtim, nevojitet një mbështetje më e angazhuar institucionale për të përmirësuar qeverisjen e mirë në terma praktikë dhe për të promovuar fuqizimin e komuniteteve rom në nivelin lokal në Kosovë.

ROMACTED në një vështrim - KOSOVË

Nisja zyrtare e Programit ROMACTED në Kosovë u bë më 31 maj 2018 si pjesë e përpjekjeve të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Me këtë rast, u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi me tetë komunat partnere: Gjakovë, Graçanicë, Mitrovica jugore, Lipjan, Fushë Kosovë, Ferizaj, Istog dhe Obiliq.

Aksioni është i koordinuar dhe monitoruar nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë duke bashkëpunuar ngushtë me Advancing Together, si organizatë mbështetëse, një pikë kontakti për Kosovën dhe një ekip facilitatorësh dhe ekspertësh vendas.

Si pjesë e përpjekjeve për të ngritur kapacitetet e autoriteteve lokale dhe komuniteteve për procesin e zbatimit të programit, janë organizuar katër punëtori për "Planifikimin Strategjik Lokal" gjatë prillit dhe majit 2018 në komunat përfituese me pjesëmarrjen e Grupeve të Veprimit në Komunitet dhe Grupet Punuese Institucionale. Punëtoritë u përqëndruan në hapat metodologjike të zbatimit të ROMACTED.

Përveç këtyre punëtorive, komunave përfituese iu ofruan edhe këto në vijim:

- Punëtori me temë "Parimet dhe mjetet për të punuar me komunitetet rome në nivelin lokal" - prill 2019;
- Trajnim për "Menaxhimin e Ciklit të Projektit" - qershor 2019;
- Trajnim për "Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Grave në Kosovë" - nëntor 2019;
- Punëtorja për "Ndihmën financiare të Bashkimit Evropian për autoritetet lokale - Instrumenti i Ndihmës Para-Anëtarësimit" (IPA) - janar 2020.

Takimi i Grupit Këshillues u mbajt në qershor 2019, duke bashkuar përfaqësuesit e autoriteteve lokale, si dhe akterët qendrorë dhe ndërkombëtarë.

Një studim gjithëpërfshirës i Vlerësimit të Kapaciteteve dhe Nevojave është realizuar gjatë vitit 2018, i përfunduar në vitin 2019, dhe është paraqitur tek palët e ndryshme të interesit të programit.

4 hapat e Metodologjisë ROMACTED

Hapi 1: PËRGATITJA E PROCESIT

ROMACTED fillimisht i është prezantuar kryetarëve të komunave ku ata siguruan angazhimin e tyre për objektivin e përgjithshëm të programit. Dy mekanizmat kryesorë të zbatimit ROMACTED - Grupet e Veprimit në Komunitet (GVK) dhe Grupet Punuese Institucionale (GPI) - u krijuan zyrtarisht në të tetë komunat gjatë tremujorit të parë të 2018. Dy komuna kanë krijuar GPI me vendim të kryetarëve të komunave, të tjera me emërime. Me qëllim të ofrimit të një qasje më të mirë në program, u krijuar një GVK shtesë në një fazë të mëvonshme në fshatin Janjevë, komuna e Lipjanit. Numri mesatar i anëtarëve të komunitetit rom që marrin pjesë në GVK është 8 (mesatarisht 2-3 gra). Kryetarët e komunave deleguan pika kontakti komunale roli i të cilëve është thelbësor në komunikimin me grupet e synuara lokale.

Hapi 2: VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE PRIORITIZIMI

Me qëllim të vlerësimit të situatës ekzistuese dhe identifikimin dhe prioritarizimin e nevojave të komunitetit dhe komunave, është bërë një Vlerësim i Kapaciteteve dhe Nevojave i cili ka përfunduar në vitin 2018. Identifikimi dhe përparësia e nevojave dhe kapaciteteve janë përdorur më pas për adresimin e çështjeve mbi Takimet e Përbashkëta me komunat përfituese (GVK dhe GPI).

Planet Lokale të Veprimit për "Integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian" janë krijuar në të tetë komunat përfituese. Veprimet e përcaktuara në PLV-të janë në përputhje me nevojat e komunitetit, afatet kohore janë brenda kohëzgjatjes së Programit ROMACTED, dhe planet janë aprovuar nga asamblatë lokale. Prandaj, ROMACTED konsideroi të punonte me LAP aktual dhe të mbështesë miratimin dhe zbatimin e tyre.

Përveç planeve lokale të veprimit, u monitorua dhe u pasua planifikimi afatgjatë komunal në projekte kapitale në komunat përfituese. Anëtarët e GVK paraqitën kërkesa me shkrim për përfshirjen e projekteve infrastrukturore, të cilat nga ana tjetër çuan në përfshirjen e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës së vendbanimeve romë në planin komunal në fund të vitit 2018. Projektet për kanalizime, gypa uji, ndriçim rruge dhe riparime të rrugëve janë realizuar gjatë vitit 2019 në disa prej përfituesve (Obiliq dhe Ferizaj).

Hapi 3: MIRATIMI I NJË PLANI TË PËRBASHKËT VEPRIMI

Dy cikle të takimeve të Grupit Punës Komunal (GPK) janë zhvilluar me GVK dhe GPI në të tetë komunat. Si pjesë e mobilizimit dhe fuqizimit të komunitetit, anëtarët e GVK morën rolin e prezantimit të nevojave prioritare për anëtarët e GPI dhe diskutimin e tyre. Dy çështje u morën nga komunat me një qasje të unifikuar. E para ka të bëjë me bursa për arsimin terciar, dhe e dyta, praktika për studentët aktualë. Sa i përket të parës, Obiliqi rishikoi Rregulloren Komunale për Bursat dhe përfshiu një qasje pozitive për studentët romë. Komunat e tjera, në varësi të qasjes dhe procedurave të brendshme, ose kanë marrë një vendim për lëshimin e bursave universitare për studentë romë (tetë në Fushë Kosovë; katër në Istog; një në Lipjan) ose janë në proces të marrja e një vendimi për lëshimin e bursave. Në lidhje me mundësitë e praktikës brenda institucioneve publike, komunat përfituese kanë ofruar një numër internshipsesh (2 deri 5) për studentët aktualë romë. Aplikimet nga studentët e interesuar ishin të pritshme në secilën komunë. Për më tepër, mbledhjet e GPK inicuan disa veprime të tjera që u realizuan bashkërisht nga komuniteti dhe komuna si më poshtë:

- Një radio program në gjuhën romë është inicuar në Radio Graçanicë. Programi transmetohet një herë në javë;
- Janë mbajtur takime bilaterale midis komunave Lipjan Graçanicë për të provuar dhe gjetur një zgjidhje për sigurimin e transportit për nxënësit e shkollave të mesme në Janjevë;
- Është ndërmarrë veprimi për pastrimin e lagjes Ali Ibra në Gjakovë përmes mobilizimit të komunitetit pas një iniciative nga pika e kontaktit komunal. ROMACTED siguroi 100 kapele për vullnetarët që morën pjesë në aksion;
- Një numër i kërkesave dhe nevojave të veçanta të komunitetit u adresuan institucioneve vendore dhe qendrore;
- U diskutuan çështjet për mbrojtjen dhe sigurinë e mjedisit dhe janë ndërmarrë veprimet p.sh. duke kërkuar/siguruar koshat e mbeturinave dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e mjedisit në lagjen romë;

- Janë ndërmarr kontrollet sistematike mjekësore për gratë rome në institucionet komunale të kujdesit shëndetësor në secilën komunë.
- Rregullorja komunale e rishikuar për Bursat në komunën e Obiliqit / Obilic e cila përfshin një qasje pozitive për studentët romë u mor si një praktikë e mirë me komunat e tjera dhe janë inkurajuar të rishikojnë të njëjtën rregullore. Komunat e tjera, varësisht nga qasja dhe procedurat e brendshme, ose kanë vendosur të lëshojnë bursa universitare për studentët romë ose janë në proces të vendosjes për lëshimin e bursave.
- U organizuan takimet tematike për të diskutuar të drejtat e pronës u të cilat u lehtësuan me autoritetet komunale dhe komunitetet rome në të gjitha komunat përfituese.

Hapi 4: FINANCIMI DHE ZBATIMI I PROJEKTIT

Disa komuna përfituese (Obiliqi, Gjakova dhe Lipjani) kanë ndarë fonde për zbatimin e planeve lokale të veprimit në komunat e tyre përkatëse. Deri më tani, komunat e tjera nuk kanë planifikuar fonde për zbatimin e planeve, që paraqet një kufizim të përgjithshëm për zbatimin e dokumenteve të politikave në lidhje me përfshirjen e romëve. Përmes takimeve të rregullta me institucionet vendore dhe trajnimeve specifike për rëndësinë e përfshirjes së romëve, financimi i përgjegjshëm për romët është futur në radarin e zyrtarëve komunal.

Të gjitha komunat pjesëmarrëse kanë aplikuar në skemën e granteve të vogla ROMACTED dhe nëntë projekte janë duke u implementuar.

Sinergjitë dhe bashkëpunimi

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) - është zhvilluar një sinergji komplimente në lidhje me ndërtimin e aftësive të administratave lokale, p.sh. parimet e qeverisjes së mirë, përfshirjen sociale të romëve, ciklin e projektit, etj. Bashkëpunimi u zgjerua me Ministrinë për Treguesit e Performancës Komunale. Një tregues specifik është zhvilluar nga ROMACTED, bazuar në formatin dhe parametrat e Ministrisë, dhe në përputhje me objektivat e ROMACTED. Ky tregues është ndarë me Ministrinë për Shqyrtim;

Ministria e Arsimit Shkencë dhe Teknologji (MASHT) - sinergji e krijuar për të ofruar mbështetje në arsim, përkatësisht në miratimin e udhëzimeve administrative dhe / ose veprimeve afirmative për politikat gjithëpërfshirëse në nivelin komunal;

Zyra për Çështje të Komunitetit në Kabinetin e Kryeministrit (ZÇK) - është rënë dakord për bashkëpunim në lidhje me projektet e lidhura me komunitetin me komunat ROMACTED. Gjithashtu, janë krijuar sinergji në bashkërendimin e çështjeve që kanë të bëjnë me romët në nivelin e politikave;

Roma Versitas Kosova (RVK) - bashkëpunim dhe mbështetje e edicionit të pestë të Rolling Film Festival në Prishtinë. Ngjarja mbledhi së bashku krijuesit e filmave me origjinë rom dhe jo-rome, të cilët promovuan kulturën dhe historinë rome. Festivali u ndoq nga një sër grupesh interesi me prejardhje të ndryshme. Për më tepër, me Roma Versitas, është krijuar bashkëpunim në lidhje me mbledhjen e të dhënave për numrin dhe fushën e studimeve të studentëve romë në të gjitha

komunat përfituese. Lista e studentëve me informacion të detajuar është ndarë nga Roma Versitas. Një takim me studentët potencial u realizua në disa nga komunat ROMACTED së bashku me Roma Versitas;

▮ UNDP ReLOaD – informacioni u nda dhe bashkërendua në lidhje me procedurën e aplikimit të grantit të UNDP ReLOaD për dy komuna, përfshirë edhe me OJQ-të rome për procedurat e aplikimit. Është krijuar një praktikë e takimeve të rregullta të bashkëpunimit midis dy programeve;

▮ Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) - është krijuar bashkëpunim në lidhje me grantet bujqësore për fermerët e vegjël. Thirrja u koordinua me Zëvendës Ministrin me qëllim të shpërndarjes së informacionit tek fermerët e mundshëm romë. ROMACTED identifikoi dhe shpërndau informacione me fermerët;

▮ Korpusi i Paqes - Ekipi mbështetës u ftua të prezantojë Programin ROMACTED gjatë një ngjarje trajnimi për grupin e 6-të të vullnetarëve të Korpusit të Paqes në Kosovë. Pas këtij bashkëpunimi, një vullnetar i Korpusit të Paqes u vendos në një OJQ rome për të ndihmuar OJQ-në Bram për një periudhë tre mujore për të ndërtuar kapacitetet e saj dhe të sigurojë mbështetje për mësimin e gjuhës angleze.;

▮ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) - është krijuar bashkërendimi dhe shkëmbimi i çështjeve që kanë të bëjnë me romët posaçërisht me Departamentin e të Drejtave të Njeriut dhe Komuniteteve. Në përpjekjen për koordinim, stafi i OSBE-së nga rajoni u ftuan të marrin pjesë në Takimet e Përbashkëta midis GVK dhe GPI të komunave përfituese. Për më tepër, thirrja e OSBE-së për pjesëmarrës të Shkollës Verore u nda midis anëtarëve të rinj të GVK. Disa prej tyre morën pjesë në shkollë, e cila kishte për qëllim promovimin e shkëmbimeve ndër-rajonale dhe ndërtimin e aftësive profesionale të ekspertëve të rinj politikë;

▮ Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) - pjesëmarrje në punëtori pas mbylljes së projektit "Promovimi i Mundësive për Punë të Denjë për Romët, Ashkali dhe Egjiptianët në Kosovë". Vlerësimi i nevojave të komunitetit ROMACTED në fushën e punësimit u prezantua në punëtori. Të gjeturat nga ILO dhe ROMACTED ishin të njëjta, dhe në një farë mënyre vërtetuan vlerësimin e bërë në komuna me GVK-të. Një vlerë e shtuar nga ana e ROMACTED ishin "zgjidhjet e mundshme" që u dhanë nga vetë komuniteti, të gjitha me synimin për të inkurajuar mobilizimin dhe motivimin nga komuniteti për zgjidhjen e problemeve;

▮ Projekti GIZ për Zhvillimin e Kapaciteteve në Arsimin Themelor (CDBE) - përpjekjet e bashkërendimit u përqëndruan në tre komuna përfituese të përbashkëta, me një shkëmbim informacioni dhe aktivitete që lidhen me projektin;

▮ Advancing Together (Organizata Mbështetëse ROMACTED) - Sinergjitë dhe bashkëpunimi u zhvilluan me Qendrën Dokumentuese dhe Kulturore të Sintit dhe Romëve gjerman në 75 vjetorin e genocidit Rom. Ngjarja edukative dhe përkujtimore "Dikh He Na Bister" u mbajt në Krakow dhe Aushvic, Poloni, dhe mblodhi së bashku anëtarët e GVK-së dhe GPI të komunave përfituese ROMACTED dhe një numër të rinjsh romë që përfaqësuan Kosovën;

▮ Rrjeti i Grave Rome Ashkallike dhe Egjiptiane (RAEWN) - kontribuoi me ekspertizën e tyre në një trajnim gjysmë ditor me gratë rome. Kjo sinergji kontribuoi shumë në shkëmbimin e informacionit

dhe rritjen e njohurive për kornizën ligjore për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave në përgjithësi. Kjo ekspertizë mund të përdoret në aktivitetet e ardhshme në lidhje me gratë;

▮ Kryetarët e komunave Fushë Kosove (2018) dhe Lipjan (2019) morën çmimin "Kryetari më miqësor rom" për Integrimin rom në kuadër të projektit "Nismë e përbashkët për fuqizimin e shoqërisë civile rome në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi", implementuar nga ERGO Network dhe Roma Active Albania. Ekipi mbështetës ROMACTED është përfshirë në mënyrë aktive në inkurajimin e aktorëve vendorë që të aplikojnë për çmimin.

Aksioni COVID-19:

Përshkruani veprimet e ndërmarra në kuadër të programit, mundësisht duke i veçuar për secilën komunë.

Në përpjekje për të përmbajtur pandeminë dhe për të siguruar që familjet më të rrezikuara brenda komuniteteve rome përfituesit ROMACTED të mos lihen pas në përgjigjen COVID-19, ROMACTED në Kosovë ka bashkërenduar përpjekjet me autoritetet komunale (AK), grupet e veprimit në komunitet (GVK) dhe organizatat ndërkombëtare (ON). Vlerësimi i përgjithshëm në terren ka treguar se situata në lagjet rome i vë komunitetet rome në rrezikun më të lartë nga infeksioni COVID-19. Në këtë drejtim, ROMACTED ndërmori veprimet e mëposhtme në secilën komunë partnere duke vënë në hartë mbështetjen e përgjithshme të ofruar nga komuna dhe organizatat e tjera (kombëtare dhe ndërkombëtare) dhe bazuar në nevojën për mbështetje shtesë.

Ferizaj – Në bashkëpunim me Roma Versitas Kosova, 61 familje më të rrezikuara (me rreth 350 individë) u pajisën me pako ushqimore dhe jo-ushqimore në katër lagje rome (Sallahane, Halit Ibishi, Koxe Xoxe dhe fshati Dubrava). Përveç paketave, u siguruan 700 maska dhe 700 doreza në të katër lagjet. Shtabi emergjent komunal siguroi transportin për shpërndarjen në të cilin ishin të përfshirë edhe anëtarët e GVK-së.

Fushë Kosovë – Duke marrë parasysh që komuna kishte kapacitete për të siguruar furnizime të konsiderueshme ushqimore dhe jo-ushqimore përveç ndihmës së ofruar nga organizata vendore dhe ndërkombëtare, ROMACTED ka mbështetur katër familjet më të rrezikuara (me 24 individë) me pako ushqimore dhe jo-ushqimore. Në një fazë të mëvonshme, pasi vlerësoi se përbërësi shëndetësor nuk ishte i mbuluar nga shumë organizata, dhe ishte nevojë mbizotëruese për familjet më të rrezikuara me sëmundje kronike, nëntë individëve u siguruan furnizime mjekësore për një muaj.

Gjakovë – Me sinergjinë e krijuar me projektin e anti-diskriminimit të KE, 130 familje më të rrezikuara (me 650 individë) do të mbështeten me pako ushqimore dhe jo-ushqimore që banojnë në lagjen Ali Ibra (Kolonja). Komuna do të sigurojë transportin e paketave dhe anëtarët e GVK-së do të mundësojnë shpërndarjen.

Graçanicë – Gjatë muajit mars dhe qershor, u siguruan pako ushqimore dhe jo-ushqimore për 21 familje (me 105 individë) për komunitetet rome dhe jo-rome dhe disa familje të cënueshme shqiptare dhe serbe. Përveç kësaj, 150 maska dhe 150 doreza janë siguruar familjet rome në fshatin Graçanicë dhe fshatin Preoce. Shtabi emergjent komunal siguroi transportin, dhe shpërndarja u mundësua nga personi i kontaktit komunal dhe anëtarët e GVK-së.

Istog – Familjet e rrezikuara u identifikuan në tre fshatra të largëta (Veric, Srbobran, Gurrakoc) dhe komunën e Istogut. 22 familje të cenueshme (me 110 individë) u pajisën me pako ushqimore dhe jo-ushqimore gjatë muajve mars dhe qershor. Për më tepër, 250 maska dhe 250 doreza u shpërndanë në komunitet. Shpërndarja e materialeve u mundësua nga Pika e kontaktit ROMACTED dhe anëtarët e GVK.

Lipjan – Gjatë kohës së karantinës në fshatin Janjevë, 70 familje të cenueshme (me 350 individë) u ndihmuan me pako ushqimore dhe jo-ushqimore. 50 familje ishin romë, 10 familje ishin shqiptare dhe 10 kroate. Përveç kësaj, 300 maska dhe 300 doreza u janë dhënë familjeve në fshatin Janjevë dhe 300 maska dhe 300 doreza për komunitetin rom në komunën e Lipjanit.

Mitrovica jugore – Në mahallën rome 35 ekonomi familjare (me 170 familje) u ndihmuan me pako ushqimore dhe jo-ushqimore që përfshinin disa gjëra thelbësore për gratë. Përveç kësaj, 300 maska dhe 300 doreza u janë dhënë familjeve në mahallën rome, dhe 300 maska dhe 300 doreza u janë dhënë familjeve rome në lagjen 2 Korriku. Transporti dhe shpërndarja u lehtësuan nga shtabi emergjent komunal dhe anëtarët e GVK-së.

Obiliq – Në bashkëpunim me Roma Versitas Kosova, 40 familje të cenueshme (me 160 individë) u ndihmuan bashkërisht në fshatin Plemetina. Shumica e familjeve të ndihmuara ishin të kthyer nga vendet e treta dhe rajoni. Shtabi emergjent komunal siguroi transportin dhe lehtësoi shpërndarjen së bashku me anëtarët e GVK-së.

ROMACTED në një vështrim Lokal

Emri i komunës: Ferizaj

Emri i kryetarit të komunës: Z. Agim Aliu

ROMACTED Kontakt Personi në komunës: Z. Selim Marevci (shefi i kabinetit) dhe z. Elbasan Osmani (zyrtar për integrimin evropian)

ROMACTED facilitatori/ët: Jehona Xhaferi

Uebfaqja e komunës: <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/>

Historiku:

Në maj të vitit 2018, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit midis Këshillit të Evropës dhe Kryetarit të Komunës së Ferizajt / Uroševac. Një pikë kontakti komunale ROMACTED u emërua nga Kryetari i Komunës për të ofruar mbështetje dhe lehtësuar procesin e zbatimit në nivelin komunal.

Grupi i Veprimit në Komunitet (GVK), Grupi Punues Institucional (GPI) dhe Grupi Punues Komunal (GPK) u krijuan zyrtarisht në Komunën e Ferizajt gjatë vitit 2018.

Dokumentet lokale të përgatitura brenda ROMACTED:

- Udhëzues operacional për Grupin Punues Institucional - mars 2018
- Udhëzues operacional për Grupin e Veprimit në Komunitet - mars 2018
- Vlerësimi i Nevojave të Komunës - shtator 2018
- Vlerësimi i Nevojave të Komunitetit - shtator 2018
- Vënia në hartë e palëve të interes/akterëve - shtator/tetor 2018

2. Arsimi:

- Bursat universitare janë planifikuar të lëshohen gjatë 2020;

- Rregullorja komunale për bursat është iniciuar për rishikim dhe përfshirja e një veprimi afirmativ për studentët nga komuniteti rom;

- Një tryezë e rrumbullakët për ndërgjegjësimin e braktisjes së shkollimit u organizua nga Departamenti i Arsimit dhe OSBE-ja në përputhje me projektin skemës së granteve të vogla për komunitetin dhe Planin Lokal të Veprimit. Anëtarët e GVK-së gjithashtu morën pjesë në diskutim;

- Projekti "Ndërmjetësimi dhe parandalimi i braktisjes së shkollës për fëmijët romë në arsimin fillor" është bashkëfinancim nga Komuna dhe skema e granteve të vogla ROMACTED.

3. Punësimi:

- Tre studentë ishin të angazhuar në programin e praktikës: dy në zyrën e nënkryetarit për komunitete dhe një në zyrën komunale të punësimit.

4. Banimi dhe prona:

- 504 shtëpi rome janë identifikuar nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim që kanë nevojë për regjistrim zyrtar;

- U mbajt një takim me komunitetin rom dhe departamentet përkatëse për të diskutuar mbi çështjen e të drejtave të pronës.

5. Investimi në projekte të infrastrukturës (asfaltimi, sistemi i ujërave të zeza dhe energjia elektrike):

- Rehabilitimi i rrugës është realizuar në lagjen Sallahane dhe Dubravë;
- Procesi i tenderit për asfaltimin në lagjen Halit Ibishi pritet të përfundojë në 2020;
- Rinovimet e sistemit të kanalizimeve janë bërë në lagjen Sallahane dhe fshatin Dubravë;
- Ndriçimi i rrugës ka përfunduar në lagjet Halit Ibishi dhe fshatin Dubravë.

6. Kultura:

Në 2018 MuralFest u zgjerua për herë të parë në një lagje rome (Sallahane) me një murale me temën "Toleranca".

7. Mjedisi:

- Grumbullimi i mbeturinave dhe parandalimi i krijimit të një deponie në fshatin Dubravë;
- Pastrimi i lumit Nerodimka në fshatin Dubravë.

8. Ndërtimi i kapacitetit:

Janë mbajtur ngjarjet e mëposhtme:

- Punëtorja për Planifikimin Strategjik Lokal Pjesëmarrës (tre GVK dhe shtatë pjesëmarrës të GPI) - maj 2018;
- Trajnim me autoritetet lokale për "Parimet dhe mjetet për përfshirjen e romëve në nivelin lokal" (dy pjesëmarrës të GPI) - prill 2019;
- Trajnim me GVK dhe GPI për Menaxhimin e Ciklit të Projektit (tre GVK dhe tre pjesëmarrës të GPI) - prill/maj 2019;
- Punëtori me të rinjtë në platformën www.ndreqe.com dhe hartë interaktive për kërkesa /ankesat e qytetarëve (dy pjesëmarrës të GVK) - tetor 2019;
- Trajnim për kornizën ligjore për barazinë gjinore (gjithsej 23 pjesëmarrës) - nëntor 2019;
- Punëtorja për Instrumentin për Ndihmën e Para-Anëtarësimit (katër pjesëmarrës të GPI) - janar 2020.

Përshkrimi i Grupit të Veprimit në Komunitet (numri i GVK, struktura e grupit, numri mesatar, balanci gjinor, shpeshësia e takimeve, etj.):

GVK është themeluar në mars 2018. Numri mesatar i anëtarëve është tre, nga të cilët një është një grua. Grupi mbledh së bashku të rinj, të kthyer, udhëheqës të komunitetit dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile rome. GVK mbledhet dy herë në muaj.

Përshkrimi i Grupit Punues Institucional (struktura e grupit/shërbimeve komunale ose departamenteve që marrin pjesë, numri mesatar i pjesëmarrësve, balanci gjinor, shpeshësia e takimeve, etj):

GPI u krijua në prill 2018. Grupi përfshin departamente dhe institucione komunale, puna e të cilave është e rëndësishme për çështjet që lidhen me romët. Numri mesatar i pjesëmarrësve është pesë, nga të cilët dy janë gra. Grupi takohet dy herë në muaj.

Përshkrimi i Grupit Punues Komunal (struktura e grupit, numri mesatar i pjesëmarrësve, shpeshësia e takimeve, etj):

GPK bashkon anëtarët e GPI dhe GVK, si dhe institucione të tjera përkatëse. Numri mesatar i pjesëmarrësve është tetë, nga të cilët dy janë gra. Grupi takohet dy herë në muaj ose kur është e nevojshme.

Plani i Përbashkët i Veprimit në fuqi? (i miratuar mes anëtarëve të GPK, duke parë nga afër nevojat dhe përparësitë e identifikuar nga komuniteti dhe është dorëzuar në Këshillin Lokal/Kryetari i Komunës për miratim):

Plani Lokal i Veprimit 16 në fuqi? (një dokument i gjerë në nivelin komunal, veprimet e të cilit janë në përputhje me Strategjinë në nivelin qendror):

ROMACTED ka përdorur Planet ekzistuese Lokale të Veprimit mbi Integrimin e Romëve në nivelin lokal duke marrë parasysh që:

- a) Planet Lokale të Veprimit janë miratuar nga asambleja lokale;
- b) ato rrjedhin nga Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Romë dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021;
- c) ato mbështesin zbatimin e veprimeve në nivelin lokal;
- d) ato korrespondojnë me nevojat e komunitetit bazuar në vlerësimin e nevojave të bëra nga ROMACTED.

Takimet e Grupit Punues Komunal të ROMACTED ofruan një platformë për shqyrtimin e nevojave prioritare të komunitetit që korrespondojnë me zbatimin e planit lokal të veprimit. Fushat e mëposhtme u morën në konsideratë: arsimi, punësimi, BANIMI dhe prona, infrastruktura, kultura, mjedisi dhe dhe projekti i granteve të vogla ROMACTED për komunitetin.

Lista e projekteve të cilat u hartuan dhe u financuan në kuadër të Programit, si dhe ato që u hartuan me kontributin e Programit, por të financuara nga burime të tjera:

Projekti mbi "Ndërmjetësimin dhe parandalimin e braktisjes së shkollës për fëmijët romë në arsimin fillor" është bashkëfinancim nga Komuna (60%) dhe skema e granteve të vogla ROMACTED (40%). Projekti mbulon katër shkolla fillore me një numër të konsiderueshëm të fëmijëve romë.

Sinergjitë e krijuara në nivelin lokal:

- Një takim koordinues me palët e interes/akterët për projektet/programet e lidhura me romët u mbajt në tetor 2018;
- OSBE mori pjesë në një nga takimet e GVK-së në gusht 2019;
- Bashkëpunimi me MuralFest rezultoi në një murale mbi "Tolerancën" të pikturuar në lagjen rome Sallahane.

¹⁶ Nëse Programi ka kontribuar në krijimin ose rishikimin e PLV-sw, ju lutemi përmendni atë. Në disa raste, nuk kishte nevojë për të miratuar Planin e Përbashkët të Veprimit veçmas, por më tepër për të rishikuar PLV rreth nevojave dhe përparësive të komunitetit.

ROMACTED në një vështrim Lokal

Emri i Komunës: Fushë Kosovë

Kryetari i Komunës: Z. Burim Berisha

ROMACTED Kontakt Personi: Z. Muhamet Xhigoli (zyrtar i thesarit)

Email: Muhamet.Xhigoli@rks-gov.net

ROMACTED facilitatori/ët: Burhan Gashi

Uebfaqja e komunës: <https://kk.rks-gov.net/fushekosove/>

Historiku:

Në maj të vitit 2018, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit midis Këshillit të Evropës dhe Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës. U emërua një pikë kontakti komunale ROMACTED nga Kryetari i Komunës për të ofruar mbështetje dhe lehtësuar procesin e zbatimit në nivelin komunal.

Grupi i Veprimit në Komunitet (GVK), Grupi Punues Institucional (GPI) dhe Grupi Punues Komunal (GPK) u krijuan zyrtarisht në Komunën e Fushë Kosovës gjatë vitit 2018.

1. Dokumentet lokale të përgatitura brenda ROMACTED:

- Udhëzues operacional për Grupin Punues Institucional - mars 2018
- Udhëzues operacional për Grupin e Veprimit në Komunitet - mars 2018
- Vlerësimi i Nevojave të Komunës - gusht 2018
- Vlerësimi i Nevojave të Komunitetit - shtator 2018
- Vënia në hartë e palëve të interesit/akterëve - nëntor 2018

2. Arsimi:

- Në vitin 2019 komuna ofroi mbështetje financiare për tetë studentë universitar rom. E njëjta gjë do të merret në konsideratë gjatë vitit 2020;

